



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 200

Tiranë – E mërkurë, 16 shtator 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 106/2026, datë 30.6.2026	Për një shtesë në vendimin nr. 59/2025, “Për përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”..... 19955
Vendim i Kuvendit nr. 107/2026, datë 30.6.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 75/2025, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë”..... 19955
Vendim i Kuvendit nr. 108/2026, datë 30.6.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 85/2026, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”..... 19955
Vendim i Kuvendit nr. 109/2026, datë 30.6.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 86/2026, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”..... 19956
Vendim i Kuvendit nr. 110/2026, datë 30.6.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 87/2026, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”..... 19956
Vendim i Kuvendit nr. 116/2026, datë 16.7.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 98/2026, “Për ngritjen e Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik”..... 19956
Vendim i Kuvendit nr. 143/2026, datë 8.9.2026	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 58/2025, “Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të Kuvendit”..... 19957
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 11.9.2026	Për miratimin e rregullores së Sistemit të Mbikëqyrjes së Kufirit..... 19957
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 680, datë 11.9.2026	Për miratimin e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 178/44, nr. 152/43 dhe nr. 182, në zonën kadastrale 1522, Bashkia Durrës, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me tarifën simbolike 1 euro, në mbështetje të investimit strategjik në fushën e turizmit, si dhe për miratimin e projekt marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe shoqërisë “OMNIX Albania” sh.p.k..... 19975

Vendim i Autoritetit të
Konkurrencës nr. 1327,
datë 11.9.2026

Mbi miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara
për zbatimin e neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, në sektorin e
transportit detar, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare
të lundrimit të lirë (*Tramp services*)”.....

**VENDIM
Nr. 106/2026****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 59/2025, “PËR PËRBËRJEN E
SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 8, 10, 10/1, 10/2, 10/3, 10/4, 10/5, 10/6 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në pikën 1, të vendimit nr. 59/2025, “Për përbërjen e sekretariateve të Kuvendit” bëhet kjo shtesë:

Deputeti Gjin Gjoni caktohet anëtar në Sekretariatin për Procedurat, Votimet dhe Etikën.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Niko Peleshi**

Miraturar në datën 30.6.2026.

**VENDIM
Nr. 107/2026****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 75/2025, “PËR NGRITJEN E
KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR
REFORMËN ADMINISTRATIVO-
TERRITORIALE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, e 78 të Kushtetutës, neneve 24, 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në pikën III, të vendimit nr. 75/2025, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën

Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë” bëhet ky ndryshim:

Deputetja Marjana Koçeku largohet si anëtare dhe zëvendësohet nga deputeti Onid Bejleri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Niko Peleshi**

Miraturar në datën 30.6.2026.

**VENDIM
Nr. 108/2026****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 85/2026, “PËR CAKTIMIN
E KRYESIVE TË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe neneve 22, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 85/2026, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit” bëhet ky ndryshim:

Deputetja Marjana Koçeku largohet si sekretare e Komisionit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe zëvendësohet nga deputetja Sara Mila.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Niko Peleshi**

Miraturar në datën 30.6.2026.

**VENDIM**
Nr. 109/2026**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN**
NR. 86/2026, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Në pikën 1, të vendimit nr. 85/2026, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit” bëhet ky ndryshim:

Deputetja Marjana Koçeku largohet si anëtare e Komisionit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 30.6.2026.

VENDIM
Nr. 110/2026**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN**
NR. 87/2026, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË
PËRBËRJEN E KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe neneve 21/1 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Në pikën IX, të vendimit nr. 87/2026, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e

komisioneve të përhershme të Kuvendit” bëhet ky ndryshim:

Deputetja Marjana Koçeku largohet si anëtare zëvendësuese në Komisionin për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën dhe zëvendësohet nga deputetja Ilva Gjuzi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 30.6.2026.

VENDIM
Nr. 116/2026**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN**
NR. 98/2026, “PËR NGRITJEN
E NËNKOMISIONIT PËR AUDITIMIN E
SEKTORIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Në pikën IV, të vendimit nr. 98/2026, “Për ngritjen e Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik” bëhet ky ndryshim:

Deputetja Zamira Sinaj largohet si anëtare dhe caktohet anëtar deputeti Elton Korreshi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 16.7.2026.

**VENDIM**
Nr. 143/2026**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN**
E KUVENDIT NR. 58/2025,
“PËR ZGJEDHJEN E
ZËVENDËSKRYETARËVE TË
KUVENDIT”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe neneve 9 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I, të vendimit nr. 58/2025, “Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të Kuvendit” bëhet ky ndryshim:

Deputetja Klodiana Spahiu zëvendësohet me deputeten Evis Kushi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 8.9.2026.

VENDIM
Nr. 677, datë 11.9.2026**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES**
SË SISTEMIT TË MBIKËQYRJES
SË KUFIRIT¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 27, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, me propozimin e

ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së Sistemit të Mbiqyrjes së Kufirit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe institucionet e përcaktuara në rregulloren e Sistemit të Mbiqyrjes së Kufirit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2027.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE E SISTEMIT TË
MBIKËQYRJES SË KUFIRIT**KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që rregullojnë funksionimin dhe administrimin e Sistemit të Mbiqyrjes së Kufirit (në vijim, Sistemi), si më poshtë vijon:

a) Përcaktimin e rregullave për raportimin në kuadër të Sistemit, përfshirë llojin, përmbajtjen dhe formatin e informacionit, që duhet të ofrohet, si dhe afatet kohore brenda të cilave duhet të kryhet raportimi;

b) Përcaktimin e modaliteteve dhe të procedurave për raportimin e situatave specifike të sigurisë kufitare;

¹ Kjo rregullore është përafëruar pjesërisht me:

- rregulloren (BE) 2019/1896, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 nëntor 2019, “Për rojat kufitare dhe bregdetare evropiane”, që shfuqizon rregulloret (BE) nr. 1052/2013 dhe (BE) 2016/1624”. Nr. CELEX 32019R1896, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 295, datë 14.11.2019, faqe 1–131;
- rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2021/581, datë 9 prill 2021, “Mbi pasqyrimin e informacionit të Sistemit Evropian të Mbiqyrjes Kufitare (EUROSUR)”. Nr. CELEX 32021R0581,

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 124, datë 12.4.2021, faqe 3–39;

- rregulloren (BE) 2016/399, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Për Kodin e Bashkimit për rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përtej kufijve (Kodi i Kufijve Shengen) (kodifikim). Nr. CELEX 32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 77, datë 23.3.2016, faqe 1–52; rekomandimin e Komisionit, nr. C (2025) 117, datë 17.1.2025, “Për krijimin e broshurës praktike për zbatimin dhe menaxhimin e EUROSUR (EUROSUR Handbook)”.



c) Përcaktimin e përgjegjësiwe institucionale dhe individuale, që lidhen me procesin e raportimit, si dhe me menaxhimin e përpunimin e raporteve të situatës;

ç) Përcaktimin e komponentëve përbërës të informacionit mbi situatën e sigurisë kufitare, si dhe të nivelit të ndikimit përkatës;

d) Përcaktimin e përgjegjësiwe për funksionimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe rrjeteve teknike, që mbështesin funksionimin e Sistemit;

dh) Përcaktimin e rregullave për garantimin e sigurisë së informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave në kuadër të Sistemit;

e) Përcaktimin e mekanizmave dhe procedurave për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë.

Neni 2 Qëllimi

Kjo rregullore zbatohet për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin për qëllimet e Sistemit, duke përfshirë informimin dhe ndërgjegjësimin për situatën, analizën e riskut, si dhe për mbështetjen e planifikimit dhe zhvillimit të operacioneve të kontrollit kufitar, si dhe të operacioneve të kërkim-shpëtimit.

Neni 3 Sistemi i Mbikëqyrjes së Kufirit

1. Sistemi i Mbikëqyrjes së Kufirit është një sistem i integruar teknik, operativ dhe organizativ, që përdoret nga autoritetet shtetërore për të monitoruar, kontrolluar e menaxhuar kufijtë tokësorë, detarë dhe ajrorë të Republikës së Shqipërisë, me qëllim garantimin e sigurisë kombëtare dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme. Sistemi garanton bashkëpunimin operacional ndërmjet të gjitha autoriteteve me përgjegjësi për kontrollin e kufijve tokësorë, detarë dhe ajrorë, si dhe me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim përmirësimin e ndërgjegjësimit për situatën e sigurisë kufitare dhe rritjen e aftësisë së reagimit për qëllime të menaxhimit të integruar të kufijve, duke përfshirë zbulimin, parandalimin dhe goditjen e imigracionit të parregullt dhe krimin ndërkufitar, si dhe kur ndodhin emergjencë, që kërkojnë ndërhyrje të strukturave të kërkim-shpëtimit, njëkohësisht

duke kontribuar në mbrojtjen dhe shpëtimin e jetës së migrantëve.

2. Sistemi shërben për kontrollet kufitare në pikat e autorizuar të kalimit kufitar dhe për mbikëqyrjen e kufijve tokësorë, detarë dhe ajrorë, duke përfshirë monitorimin, zbulimin, identifikimin, gjurmimin, parandalimin dhe goditjen e kalimeve të paautorizuara kufitare.

3. Në funksion të sigurisë kufitare dhe të shkëmbimit të informacionit, si dhe për bashkëpunimin në fushën e mbikëqyrjes së kufirit, Policia Kufitare dhe Migracionit, dhe agjencitë e tjera kombëtare bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion ndërmjet tyre, si dhe me agjencitë ndërkombëtare, nëpërmjet Sistemit, i cili përbëhet nga këta komponentë funksionalë:

a) Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (në vijim, Qendra Kombëtare e Koordinimit), e cila është struktura ndërinstitucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e informacionit të përfshirë. Ajo është përgjegjëse për grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit, si dhe për koordinimin ndërinstitucional e ndërkombëtar në fushën e sigurisë kufitare;

b) Situata kombëtare e sigurisë kufitare, e cila është tabloja e përditësuar operative që pasqyron:

- i. flukset migratore;
- ii. incidentet kufitare;
- iii. rreziqet e identifikuara;
- iv. aktivitetet e paligjshme;

c) Situata të veçanta të sigurisë kufitare, të cilat janë pamje specifike operative, që krijohen në raste:

- i. krizash migratore;
- ii. rritjesh të papritura të flukseve;
- iii. emergjencash apo kërcënimesh të veçanta;

ç) Situata rajonale dhe evropiane e sigurisë kufitare, e cila është integrimi i informacionit dhe analizave nga partnerët rajonalë dhe evropianë për të siguruar ndërgjegjësim të përbashkët mbi kërcënimet ndërkufitare dhe zhvillimet migratore;

d) Rrjeti i komunikimit, i cili është infrastruktura e sigurt teknike, që mundëson:

- i. shkëmbim të sigurt informacioni në kohë reale;
- ii. transmetim të të dhënave operative;
- iii. komunikim të enkriptuar ndërinstitucional dhe ndërkombëtar;

dh) Informacioni për situatën në zonën kufitare dhe parakufitare, që janë dokumente analitike dhe operative, që:



i. vlerësojnë rreziqet;
ii. identifikojnë tendencat;
iii. propozojnë masa parandaluese dhe operacionale;

e) Zbatimi i përbashkët i metodave të mbikëqyrjes dhe planifikimi i integruar, procesi përmes të cilit:

i. harmonizohen burimet njerëzore dhe teknike;
ii. planifikohen operacione të përbashkëta;
iii. zbatohet qasje e koordinuar ndërmjet institucioneve.

4. Sistemi i Mbikëqyrjes së Kufirit udhëhiqet nga qasja e bazuar në inteligjencë dhe analizë të riskut, duke u siguruar autoriteteve kombëtare, rajonale dhe evropiane të informohen për situatën e sigurisë kufitare, duke u mundësuar atyre të reagojnë sa më shpejt ndaj rrugëve dhe metodave të reja të migracionit të parregullt dhe krimit ndërkufitar, i cili përfshin shkëmbimin e informacionit në kohë pothuajse reale, ndarjen e rregullt të inteligjencës dhe bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet autoriteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian.

Neni 4

Parimet e funksionimit

1. Në nivel kombëtar, agjencitë e zbatimit të ligjit, që operojnë në kufi, si dhe Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare bashkëpunojnë dhe raportojnë për situatën kombëtare të sigurisë kufitare, raporte, të cilat menaxhohen e përditësohen nga Qendra Kombëtare e Koordinimit. Qendra Kombëtare e Koordinimit mbështet drejtimin dhe kontrollin operacional, duke përfshirë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve.

2. Në nivel rajonal dhe evropian, Qendra Kombëtare e Koordinimit realizon shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin operacional me Qendrat Kombëtare të Koordinimit të vendeve fqinje dhe vendeve partnere, si dhe me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX), në cilësinë e pikës së vetme kombëtare të kontaktit. Kjo veprimtari ushtrohet për qëllimet e Kornizës për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Sistemit Evropian të Mbikëqyrjes Kufitare (EUROSUR). Një shkëmbim i tillë i informacionit kontribuon dhe siguron akses në situatën evropiane të sigurisë

kufitare dhe të situatave të veçanta të sigurisë kufitare.

3. Për reagimin në kohë ndaj ngjarjeve të veçanta, si dhe ndaj situatave kritike në kufi, kufiri do të ndahet në sektorë kufitarë, secilës prej të cilave i atribuohet një nivel i caktuar ndikimi. Kjo qasje do të lejojë identifikimin dhe klasifikimin e kufijve në nivele të standardizuara ndikimi, duke rritur kështu aftësinë e reagimit në nivel kombëtar dhe duke lehtësuar mbështetjen nga FRONTEX-i, nëse kërkohet. Kjo qasje mbështet, gjithashtu, planifikimin e shpërndarjes proporcionale të personelit të agjencive të zbatimit të ligjit, që operojnë në kufi, si dhe të trupave të përhershëm të Rojës Evropiane Kufitare dhe Bregdetare dhe reagimeve të tjera në seksionet kufitare, në kuadër të zhvillimit të operacioneve të përbashkëta, në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara.

4. Planifikimi i integruar për menaxhimin e kufirit përfshin planifikimin operacional, planifikimin e emergjencës dhe planifikimin e zhvillimit të kapaciteteve. Ai bazohet në skenarë të nxjerrë nga aktivitetet e analizës së riskut. Njëkohësisht, EUROSUR-i apo vendet fqinje mund të ofrojnë informacion mbi situatën në kufi dhe zonën parakufitare, e cila mbështet planifikimin e integruar. Planet operacionale dhe planet e emergjencës do të jenë pjesë e informacionit mbi situatën kombëtare të sigurisë kufitare, që mbështet operacionet e sigurisë kufitare në nivel kombëtar, si dhe të operacioneve të përbashkëta me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare.

Neni 5

Dimensioni ndërkombëtar

Qendra Kombëtare e Koordinimit bashkëpunon dhe shkëmben informacion me vendet fqinje, vendet e rajonit, me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare, si dhe institucione, organizata, agjenci ose zyra të tjera të Bashkimit Evropian, si dhe organizata ndërkombëtare, bazuar në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, në kuadër të marrëveshjeve të punës ose marrëveshjeve të statusit, që përmbajnë dispozita mbi shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin operacional në kuadër të EUROSUR-it.



Neni 6 Fushëveprimi

Fusha e veprimit e Sistemit do të jetë:

1. Kontrolli kufitar:

- a) verifikimet në pikat e kalimit kufitar;
- b) mbikëqyrja e kufirit tokësor, detar dhe ajror;
- c) lëvizjet dytësore të paautorizuara, kur ndodhin;
- c) krimi ndërkufitar.

2. Ndërgjegjësimi për situatën:

a) monitorimi, identifikimi, gjurmimi, analizimi dhe raportimi i aktiviteteve të paligjshme ndërkufitare, me qëllim mbështetjen e autoriteteve kompetente në vlerësimin e nevojës për reagim;

b) ndërthurja e informacionit të ri me atë ekzistues;

c) ofrimi i një tabloje sa më reale të situatës së sigurisë kufitare dhe parakufitare;

c) pozicioni dhe statusi operacional i Qendrës Kombëtare të Koordinimit dhe qendrave të koordinimit, komandës dhe kontrollit të operacioneve të kontrollit kufitar;

d) fushat e përgjegjësisë për mbikëqyrjen kufitare dhe për verifikimet në pikat e kalimit kufitar;

dh) lloji dhe shpërndarja e njësive të kontrollit kufitar dhe statusi i tyre.

3. Aftësitë reaguese:

a) sigurimi i informacionit, koordinimit dhe mbështetjes së nevojshme për reagimin operacional të autoriteteve kompetente ndaj aktiviteteve të paligjshme ndërkufitare në, përgjatë ose afër kufirit, duke përfshirë informacionin mbi mjetet dhe afatet kohore të nevojshme për reagim, në përputhje me rolin kombëtar të Qendrës Kombëtare të Koordinimit;

b) përmbledhja e planeve operationale dhe planeve të emergjencës.

4. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet aktorëve në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

5. Të dhënat që lidhen me numrat e identifikimit të anijeve, avionëve apo mjeteve të tjera të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Neni 7 Të drejtat themelore

1. Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kombëtare, si dhe bashkëpunimi me vendet fqinje, vendet e rajonit dhe Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe

Bregdetare duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar të të drejtave themelore, duke përfshirë parimin e moskthimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Autoritetet kombëtare përgjegjëse për sigurinë kufitare janë të detyruara të përmbushin dhe të zbatojnë në mënyrë rigorozë detyrimet që burojnë nga Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, nga legjislacioni kombëtar në fushën e menaxhimit të kufijve dhe azilit, si dhe nga të gjitha instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme në fushën e të drejtave të njeriut, të së drejtës së refugjatëve dhe të së drejtës ndërkombëtare detare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Në ushtrimin e kompetencave të tyre, këto autoritete janë të detyruara të respektojnë dhe garantojnë të drejtat themelore të çdo personi, duke treguar një kujdes të shtuar për personat në situata vulnerabël, përfshirë, por pa u kufizuar në, të drejtën për jetën dhe të drejtën për dinjitet njerëzor, si dhe të sigurojnë zbatimin e parimit të mosdiskriminimit, duke mos ushtruar asnjë dallim apo trajtim të pabarabartë mbi bazën e seksit, racës, gjendjes sociale apo origjinës etnike, gjuhës, fesë ose bindjeve, pikëpamjeve politike apo çdo mendimi tjetër, aftësisë së kufizuar, moshës apo orientimit seksual.

4. Çdo masë e ndërmarrë gjatë ushtrimit të detyrave përkatëse duhet të jetë në përputhje me parimin e ligshmërisë dhe të respektojë parimin e proporcionalitetit, duke qenë e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektivave të ligjshëm, që synohen të realizohen përmes masave të tilla.

Neni 8 Mbrojtja e të dhënave personale

1. Autoritetet kombëtare, qoftë gjatë aktivitetit të tyre të përditshëm, por edhe në kuadër të bashkëpunimit me partnerët rajonalë dhe evropianë, respektojnë legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, për mbrojtjen e të dhënave personale në të gjitha aktivitetet e tyre të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Të dhënat personale përpunohen në mënyrë të tillë që të garantohet siguria e nevojshme e të dhënave personale gjatë përpunimit automatik dhe joautomatik, duke përfshirë mbrojtjen nga përpunimi i paautorizuar ose i paligjshëm, humbja, shkatërrimi ose dëmtimi aksidental, nëpërmjet



përdorimit të masave të duhura teknike dhe organizative.

3. Të dhënat personale përpunohen vetëm në funksion të raporteve të situatës kombëtare të sigurisë kufitare, si dhe të raporteve të situatave specifike të sigurisë kufitare.

4. Të dhëna të tilla personale mund të përpunohen vetëm nëse synojnë përmirësimin e ndërgjegjësimit për situatën dhe rritjen e aftësisë së reagimit, për qëllime të menaxhimit të kufirit, duke përfshirë zbulimin, parandalimin dhe goditjen e imigracionit të paligjshëm dhe krimin ndërkufitar, si dhe për të kontribuar në sigurimin e mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës.

5. Çdo shkëmbim i të dhënave personale me shtetet e tjera ose me organizatat ndërkombëtare kufizohet në mënyrë të rreptë vetëm në atë masë, që është absolutisht e nevojshme për realizimin e detyrimeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Çdo transferim ose shkëmbim ndërkombëtar i të dhënave personale, përfshirë dërgimin tek institucionet, organet, agjencitë ose zyrat e Bashkimit Evropian, si dhe tek organizatat ndërkombëtare, u nënshtrohet dispozitave të posaçme për mbrojtjen e të dhënave, të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të punës ose të bashkëpunimit, si dhe kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe/ose me planet operative përkatëse, të cilat zbatohen në kuadër të marrëveshjeve të statusit me Bashkimin Evropian.

6. Çdo shkëmbim ndërkombëtar informacioni që mund të ofrojë të dhëna që mund të përdoren për të identifikuar personat ose grupet e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare ose që janë nën rrezik serioz për t'u nënshtroar torturës, trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor dhe degradues, ose çdo shkeljeje tjetër të të drejtave themelore, është i ndaluar.

7. Për çdo veprim lidhur me aksesin dhe çdo proces tjetër përpunimi të të dhënave personale sigurohet gjurmueshmëria, me qëllim garantimin e konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë, qëndrueshmërisë së sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit.

8. Të dhënat personale ruhen për një periudhë jo më të gjatë se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato përpunohen, dhe fshihen ose asgjësohen menjëherë pas përmbushjes së këtij qëllimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 9

Kërkim-shpëtimi

1. Autoritetet kombëtare, që përmbushin detyrimet e tyre për të ofruar ndihmë për çdo mjet lundrimi ose individ në vështirësi në det dhe gjatë një operacioni të mbikëqyrjes së kufirit detar, duhet të sigurojnë që njësitë e tyre pjesëmarrëse të përmbushin këtë detyrim, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe duke respektuar të drejtat themelore.

2. Në kuadër të bashkëpunimit operacional me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEx), autoritetet kombëtare, përveç legjislacionit kombëtar, zbatojnë edhe standardet e rregullat e Bashkimit Evropian në fushën e mbikëqyrjes kufitare, të transpozuar në legjislacionin kombëtar për kontrollin e kufirit shtetëror.

Neni 10

Personat vulnerabël

1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve për mbledhjen e informacionit dhe kontrollin kufitar, autoritetet kombëtare marrin masa për identifikimin dhe trajtimin e veçantë të personave në situatë vulnerabiliteti në nevojë për ndihmë të menjëhershme shëndetësore apo sociale, përfshirë, por pa u kufizuar në, fëmijët, veçanërisht fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë nga prindërit, kujdestarët ligjorë, gratë shtatzëna, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, personat me nevoja të veçanta shëndetësore ose psikologjike, si dhe viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës ose formave të tjera të shfrytëzimit. Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit dhe strukturat përgjegjëse në nivel lokal, rajonal ose kombëtar, sigurojnë ndërmarrjen e menjëhershme të masave të nevojshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit, sigurisë dhe dinjitetit njerëzor, përfshirë ofrimin e ndihmës së parë dhe, kur është e nevojshme, ndihmën mjekësore emergjente. Në rastin e fëmijëve, çdo veprim ndërmerret në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

2. Siguria e ekuipazhit dhe e personave që kanë nevojë për ndihmë mjekësore konsiderohet prioritet absolut dhe të gjitha veprimet duhet të kryhen në mënyrë të tillë që të garantojnë ruajtjen e kësaj sigurie në çdo kohë.



KREU II
BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I
INFORMACIONIT

Neni 11

Qendra Kombëtare e Koordinimit

1. Qendra Kombëtare e Koordinimit është struktura që koordinon dhe shkëmben informacion ndërmjet të gjitha autoriteteve kombëtare përgjegjëse për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, me Qendrat Kombëtare të Koordinimit të vendeve të tjera dhe me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare.

2. Qendra Kombëtare e Koordinimit është pika e vetme e kontaktit për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin operacional, në kuadër të Sistemit Evropian të Mbikëqyrjes Kufitare (EUROSUR), dhe do të shërbejë si e tillë.

3. Qendra Kombëtare e Koordinimit ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në ligj dhe organizohet e funksionon sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Autoritetet kombëtare

1. Qendra Kombëtare e Koordinimit përbëhet nga përfaqësues të agjencive kryesore të zbatimit të ligjit, që operojnë në kufi, konkretisht:

- a) Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin;
- b) Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;
- c) Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2. Qendra Kombëtare e Koordinimit siguron shkëmbimin në kohë të të dhënave dhe bashkëpunimin e rregullt ndërmjet autoriteteve kombëtare, nëpërmjet sistemeve të ndërveprimit dhe kanaleve të sigurta të komunikimit.

3. Për përmbushjen e detyrave funksionale, Qendra Kombëtare e Koordinimit shkëmben informacion dhe bashkëpunon, në çdo rast kur është e nevojshme, për qëllimet e kësaj rregulloreje dhe të sigurisë kufitare, nëpërmjet kanaleve të sigurta të komunikimit, nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave, sipas standardeve të ndërveprimit dhe sigurisë me autoritete të tjera kombëtare që veprojnë si dhënës dhe përfitues të të dhënave, të tilla si:

- a) Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit;

b) Drejtoria e Përgjithshme Detare nëpërmjet Kapitanerisë së Porteve;

c) autoriteti i kontrollit të peshkimit;

ç) oficerët ndërlidhës të imigracionit;

d) shërbimet veterinarë/fitosanitare;

dh) Drejtoria Konsullore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ambasadat dhe konsullatat;

e) autoritetet përgjegjëse për parandalimin e përhapjes së armëve bërthamore;

ë) autoriteti përgjegjës për transportin;

f) shërbimet e mbrojtjes civile;

g) autoritetet përgjegjëse për mjedisin;

gj) shërbimet e inteligjencës;

h) autoritetet përgjegjëse për mekanizmin e referimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për shërbimet e mbrojtjes për grupet e tjera vulnerabël, siç janë fëmijët;

i) autoritetet e shëndetit publik;

j) Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD).

4. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, autoritetet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, caktojnë pika kontakti për shkëmbimin e të dhënave, duke garantuar përdorimin e kanaleve të sigurta të komunikimit dhe kontrollin e aksesit.

Neni 13

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kombëtare

1. Autoritetet kombëtare, që janë përgjegjëse për kontrollin kufitar, do të bashkëpunojnë në kuadër të Qendrës, brenda fushës së përgjegjësisë së tyre, të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore.

2. Autoritetet kombëtare do të respektojnë fushat e përgjegjësisë së njëri-tjetrit dhe nuk duhet të kryejnë veprime që mund të ndikojnë negativisht drejtpërdrejt ose tërthorazi tek autoritetet e tjera në përmbushjen e detyrave të tyre.

3. Në varësi të qëllimit të bashkëpunimit dhe përgjegjësisë të autoriteteve përkatëse, të parashikuara nga legjislacioni kombëtar, bashkëpunimi realizohet në fushat e mëposhtme:

a) Shkëmbimi i informacionit: autoritetet kombëtare ndajnë informacionin e nxjerrë nga sistemet e tyre, si dhe nga raportet e ngjarjeve, raportet operacionale, raportet e operacioneve të kërkim-shpëtimit në kufirin shtetëror, dhe të analizës së situatës kombëtare të sigurisë kufitare.



Autoritetet kombëtare shkëmbejnë, për aq sa lejohet nga legjislacioni, informacionin e nxjerrë nga infrastruktura e tyre e mbikëqyrjes dhe operacionet e kontrollit kufitar në nivel lokal, mundësisht në kohë pothuajse reale;

b) Bashkëpunimi logjistik: autoritetet kombëtare përdorin bashkërisht infrastrukturën e mbikëqyrjes së kufirit dhe të verifikimeve kufitare, ofrojnë akses të kontrolluar në sistemet dhe bazat e të dhënave të njëra-tjetrës, mbi bazën e parimit “nevojë për njohje”, kryejnë analiza të përbashkëta të riskut dhe koordinojnë aktivitetet e tyre të kontrollit kufitar;

c) Mbështetja: një autoritet kombëtar mund t'i ofrojë mbështetje një autoriteti tjetër në kryerjen e detyrave të kontrollit kufitar. Përgjegjësia dhe autoriteti për të kryer detyrat i mbeten autoritetit të ngarkuar me ligj.

4. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve përkatëse realizohet në forma të ndryshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në sa vijon:

a) Personeli i një autoriteti kombëtar mund të ofrojë informacion, si dhe mbështetje operacionale, analitike, teknike dhe administrative për një autoritet tjetër kombëtar, në përputhje me kompetencat dhe legjislacionin në fuqi;

b) Infrastruktura e mbikëqyrjes dhe e komunikimit mund të përdoret në mënyrë të përbashkët, me qëllim sigurimin e informimit në kohë reale mbi situatën në zonën kufitare dhe parakufitare;

c) Përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve mund të koordinohet ndërmjet autoriteteve, me qëllim rritjen e efektivitetit operacional dhe përmirësimin e aftësisë së përgjithshme të reagimit;

ç) Miratimi dhe zbatimi i procedurave të përbashkëta standarde të punës për procese të ndryshme operative dhe administrative;

d) Personeli i autoriteteve përkatëse mund t'u nënshtrohet trajnimeve të përbashkëta, me qëllim standardizimin e praktikave profesionale, rritjen e kapaciteteve dhe harmonizimin e mënyrave të reagimit.

5. Qendra Kombëtare e Koordinimit harton e përditëson, vazhdimisht, listën e pikave të kontaktit të autoriteteve kombëtare dhe të autoriteteve të tjera të listuara në pikën 3, të nenit 12, të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit në rastet e kërkim-shpëtimit

1. Për të kontribuar në mbrojtjen dhe shpëtimin e jetës së migrantëve në det dhe në veçanti për të siguruar shkëmbimin në kohë të informacionit dhe vërejtjeve që lidhen me ngjarje të mundshme të kërkim-shpëtimit, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare është e nevojshme të shkëmbejë informacion të vazhdueshëm me Qendrën Kombëtare të Koordinimit.

2. Shkëmbimi i informacionit duhet të kryhet duke marrë parasysh faktin se Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare është ekskluzivisht përgjegjëse për fillimin dhe koordinimin e çdo operacioni që lidhet me kërkim-shpëtimin, duke vepruar sipas instrumenteve specifike ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-shpëtimit. Çdo incident kufitar që kërkon ndërhyrje të menjëhershme raportohet pa vonesë.

3. Shkëmbimi i informacionit duhet të përfshijë:

a) informacion në lidhje me statusin dhe vendndodhjen e mjeteve të patrullimit (i rëndësishëm për të dyja qendrat për vlerësimin e aftësisë së tyre të reagimit) dhe vendosja në dispozicion të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare, nga Qendra Kombëtare e Koordinimit, e produkteve të analizës së riskut, për flukset migratore, të cilat përbëjnë burim rreziku potencialisht të lartë për jetët në det;

b) Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare dhe Qendra Kombëtare e Koordinimit mund të ndajnë me njëra-tjetrën kapacitetet e tyre të komunikimit dhe gjurmimit satelitor, tokësor dhe detar, duke përfshirë ato të disponueshme, në kuadër të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare;

c) informimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare, në lidhje me ngjarjet që fillimisht nuk kërkojnë veprime të kërkim-shpëtimit, por mund të shndërrohen më vonë në ngjarje të tilla, duke mundësuar një gatishmëri dhe një informim më të mirë të situatës për Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare. Gjithashtu, Qendra Kombëtare e Koordinimit duhet të informohet për çdo rast kërkim-shpëtimi, që përfshin migrantë ose që lidhet me situatën kufitare;



ç) Qendra Kombëtare e Koordinimit mund të ndihmojë Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare në zgjedhjen e pikës së zbarkimit, nëse është e nevojshme dhe nëse kërkohet nga Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, e cila është përgjegjëse për zgjedhjen e vendit të zbarkimit.

4. Autoritetet kufitare mund të kërkojnë asistencë nga organizata ndërkombëtare të specializuara në kërkim-shpëtim, kur situata e emergjencës e tejkalon kapacitetin kombëtar.

5. Në rast operacioni kërkim-shpëtimi, që prek kufirin me një shtet fqinj, autoritetet kufitare aktivizojnë marrëveshjet ndërkufitare dhe sigurojnë bashkëpunim të plotë me autoritetet e vendit fqinj.

Neni 15

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe logjistike

Qendra Kombëtare e Koordinimit do të mbështesë menaxhimin efektiv të burimeve dhe personelit nga autoritetet kombëtare përgjegjëse për kontrollin e kufirit, duke mbështetur planifikimin dhe zbatimin e integruar të aktiviteteve të kontrollit kufitar, duke përfshirë:

1. krijimin dhe përditësimin e një pamjeje të përgjithshme të të gjitha aseteve të disponueshme, që marrin pjesë në aktivitetet e kontrollit kufitar, duke përfshirë pozicionin e aseteve dhe statusin operacional, zonën e përgjegjësisë, llojin dhe shpërndarjen e njësive të kontrollit kufitar;

2. koordinimin e shpërndarjes së aseteve të disponueshme në nivel kombëtar në seksionet kufitare, që korrespondojnë me nivelet e riskut të alokuara për ato seksione. Këtu mund të përfshihet rishpërndarja e aseteve të ofruara nga një autoritet kombëtar nga një seksion kufitar në një tjetër, ose ndarjen e aseteve shtesë të ofruara nga një autoritet tjetër kombëtar për të forcuar masat e mbikëqyrjes në një seksion të caktuar kufitar;

3. mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve kombëtare të zhvillimit të kapaciteteve, duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet kombëtare përkatëse, ku mund të përfshihet identifikimi i boshllëqeve dhe i nevojave, që lidhen me:

a) informacionin e mbledhur nga sisteme të ndryshme, sensorë, patrullime, duke përfshirë sistemet për kontrollin kufitar dhe burime të tjera;

b) sistemet dhe rrjetet e sensorëve të lartpërmendura, duke përfshirë integrimin e tyre;

c) infrastrukturën e kërkuar të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe kapacitetin e ruajtjes;

ç) aftësitë dhe mjetet për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e informacionit;

d) asetet stacionare dhe të lëvizshme;

dh) disponueshmërinë e personelit dhe profileve të përshtatshme;

e) trajnimin e personelit, duke përfshirë trajnimin për personelin e Qendrës Kombëtare të Koordinimit.

4. Mbështetjen për planifikimin, zbatimin dhe përshtatjen e aktiviteteve dhe operacioneve të kontrollit kufitar në nivel lokal e kombëtar, si dhe, kur kërkohet, në nivel rajonal dhe evropian.

KREU III

SITUATA E SIGURISË KUFITARE

Neni 16

Situata kombëtare e sigurisë kufitare

1. Raporti i situatës kombëtare të sigurisë kufitare është një nga tri raportet e situatës, në kuadër të Sistemit të Mbikëqyrjes së Kufirit. Qëllimi i tij është t'u ofrojë autoriteteve kombëtare, që kanë përgjegjësi për kontrollin kufitar në nivel kombëtar, informacion efektiv, të saktë dhe në kohë. Raporti mund t'u shërbejë, gjithashtu, vendimmarrësve në nivel kombëtar, të cilët janë përgjegjës për vendimet strategjike, me informacion të rëndësishëm mbi situatën në kufi.

2. Raporti është, gjithashtu, thelbësor në nivel operacional, për autoritetet kombëtare përgjegjëse për kontrollin kufitar, në mënyrë që të monitorojnë dhe të reagojnë, në mënyrë të përshtatshme, ndaj ngjarjeve dhe situatave të papritura në kufij, në mënyrë të saktë dhe në kohë, dhe të parashikojnë zhvillimet e mundshme të situatës, si dhe të identifikojnë kërcënimet ose sfidat e mundshme. Raporti nuk duhet të konsiderohet si një produkt ose program i vetëm kompjuterik, por si një grup informacionesh nga burime të ndryshme, i cili mund të mblidhet dhe shpërndahet në përputhje me nevojat e përdoruesve fundorë.

3. Qendra Kombëtare e Koordinimit është përgjegjëse për hartimin dhe përditësimin e raporteve të situatës kombëtare të sigurisë kufitare



përmbledhjes, vlerësimit, krahasimit, analizës, interpretimit, gjenerimit, vizualizimit dhe shpërndarjes së informacionit. Qendra Kombëtare e Koordinimit duhet të ndajë informacion rregullisht, nëpërmjet raporteve të situatës kombëtare të sigurisë kufitare, me të gjitha autoritetet kombëtare përgjegjëse për kontrollin e kufirit.

4. Raportet e situatës kombëtare të sigurisë kufitare hartohen dhe shpërndahen mbi baza ditore dhe përfshijnë zhvillimet gjatë 24 orëve paraardhëse.

5. Procedurat standarde të punës për shkëmbimin e informacionit në kuadër të raporteve të situatës kombëtare të sigurisë kufitare, përmbajtja dhe forma e raportit, miratohen me urdhër të

përbashkët të titullarëve të autoriteteve kombëtare përgjegjëse, sipas pikës 3, të nenit 28, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”.

Neni 17

Burimet e informacionit

1. Për hartimin e raporteve të situatës kombëtare të sigurisë kufitare, Qendra Kombëtare e Koordinimit mund të shfrytëzojë burime të ndryshme informacioni, duke respektuar parashikimet e legjislacionit të posaçëm në fuqi.

2. Në mënyrë të përmblodhur, burimet e informacionit mund të jenë:

Kategoria e burimit të informacionit	Listë joshteruese e burimeve të informacionit
Sistemet kombëtare të mbikëqyrjes së kufirit	1. Sistem(e) të mbikëqyrjes së kufirit tokësor; 2. Sistem(e) të mbikëqyrjes së hapësirës detare; 3. Sistem(e) të mbikëqyrjes së kufirit ajror.
Pajisje dhe sisteme stacionare dhe lëvizëse të mbikëqyrjes së kufirit	1. Radarë: pozicioni, kursi, shpejtësia, koha, madhësia e objektivit; 2. Kamera: fotografi, video, kohë, drejtim, të dhëna të përpunuara me imazh; 3. Kamera të kontrolluara me rreze aktive: distanca e objektivit, klasifikimi i mjetit lundrues; 4. Sensorë/sisteme drejtimi me frekuencë radioje: pozicioni, frekuenca operative, lloji i radios; 5. Sisteme hidrofonike: të dhëna lëvizjeje të mjeteve të lundrimit, klasifikimi i mjeteve të lundrimit;
Patrullat e mbikëqyrjes së kufirit dhe aktivitetet apo operacione të tjera të mbikëqyrjes së kufirit	1. Aktivitetet e mbikëqyrjes së kufijve detarë, tokësorë dhe ajrorë, duke përfshirë të gjitha raportet, planet, produktet analitike dhe platformat teknike përkatëse që shfaqin, për shembull, vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve; 2. Misionet e kërkim-shpëtimit; 3. Aktivitetet që lidhen me doganat; 4. Informacion nga verifikimet dhe kontrollet policore në kufi dhe në territor, të cilat kanë lidhje me sigurinë kufitare; 5. Aktivitete apo operacione të kontrollit të peshkimit.
Qendra lokale, rajonale apo qendra të tjera koordinimi	1. Raporte dhe informacione nga qendrat lokale dhe rajonale të koordinimit; 2. Raporte apo informacione nga qendra koordinimi për shpëtimin detar dhe nënqendra përkatëse; 3. Raporte apo informacione nga qendra ndërkombëtare të koordinimit.
Autoritete apo sisteme të tjera, përfshirë oficerët ndërlidhës	1. Pikat kombëtare të kontaktit për parandalimin e migracionit të parregullt dhe krimit ndërkufitar; 2. Qendrat për bashkëpunim ndërkufitar/policor/ doganor; 3. Qendrat kombëtare për kontrollin e peshkimit; 4. Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD); 5. Strukturat e mbrojtjes së mjedisit detar; 6. Shërbimet kombëtare të emergjencës; 7. Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (situata pandemie);



	8. Ambasadat, konsullatat dhe oficerët e ndërlidhjes të vendeve të tjera të akredituara në Shqipëri; 9. Strukturat e ndryshme të policisë; 10. Roja bregdetare; 11. Autoritetet kombëtare përgjegjëse për mbikëqyrjen e hapësirës ajrore; 12. Në situata emergjente ose të jashtëzakonshme: autoritete të tjera kombëtare që nuk janë të listuara më sipër; 13. Ambasadat, konsullatat dhe oficerët e ndërlidhjes të vendit tonë të akredituara në vende të tjera.
Verifikimet kufitare	1. Verifikimet kufitare të personave; 2. Verifikimet kufitare të mjeteve të transportit, bagazheve dhe objektet në posedim të personave që kalojnë kufirin; 3. Mjetet e mbikëqyrjes audiovizive, apo të tjera, në pikat e kalimit kufitar;
Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEx)	1. Shërbimet e EUROSUR-it; 2. Produktet analitike të Agjencisë (për shembull, nivelet e ndikimit të alokuara për seksionet kufitare); 3. Raportet e situatës të përgatitura nga Agjencia; 4. Operacionet e përbashkëta; 5. Informacion mbi mjetet dhe pajisjet e vetë Agjencisë; 6. Produktet e tjera të Agjencisë.
Qendrat Kombëtare të Koordinimit të vendeve të rajonit dhe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian	1. Vendet fqinje anëtare të Bashkimit Evropian: pozicionet, statusi dhe lloji i aseteve të veta që veprojnë në këto seksione kufitare; 2. Ngjarje të veçanta; 3. Raportet e analizës taktike të rrezikut dhe, ndoshta, patrullime; 4. Rrjetet rajonale.
Sistemet e raportimit të mjeteve lundruese	1. Sistemi i Identifikimit Automatik (AIS); 2. Sistemi i Monitorimit dhe Informacionit të Trafikut të Anijeve (VTMIS); 3. Sistemi i Informacionit dhe Shkëmbimit Detar të Unionit, duke përfshirë <i>SafeSeaNet</i> (SSN) dhe sistemin e identifikimit dhe gjurmimit në distancë të gjatë (LRIT).
Sistemet e raportimit të avionëve	1. Teknologjitë e mbikëqyrjes së aviacionit të miratuara nga ICAO-ja;
Organizata të tjera	1. Institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e BE-së; 2. Organizatat ndërkombëtare;
Burime të tjera	1. Sisteme të tjera informacioni në përdorim nga partnerët ndërkombëtarë (kryesisht për qëllime statistikore); 2. Burime të hapura; 3. Plane operationale ose të emergjencës.

Neni 18

Situata rajonale dhe evropiane

1. Qendra Kombëtare e Koordinimit do të kontribuojë me informacion në përpilimin e raporteve të situatës evropiane të sigurisë kufitare, të cilat hartohen nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare. Informacioni, në kuadër të situatës evropiane të sigurisë kufitare do t'i ofrohet Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare.



2. Njëkohësisht, Qendra Kombëtare e Koordinimit shkëmben informacion me vendet fqinje dhe vendet e rajonit, kur vlerësohet e nevojshme, me qëllim mbështetjen për vlerësimin e situatës kufitare dhe ndikimin e situatave në sigurinë kufitare të këtyre vendeve.

3. Qendra Kombëtare e Koordinimit mund të kërkojë informacion nga vendet fqinje rreth situatës së sigurisë parakufitare, me qëllim hartimin e raporteve të vlerësimit të riskut ndaj sigurisë kufitare të vendit tonë, informacione të cilat do u vihen në dispozicion autoriteteve vendimmarrëse.

4. Për hartimin e raporteve të situatës rajonale dhe evropiane të sigurisë kufitare, përveç informacioneve të marra nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare, dhe nga strukturat homologe të vendeve fqinje dhe të rajonit, Qendra Kombëtare e Koordinimit mund të shfrytëzojë burime të ndryshme informacioni, duke respektuar parashikimet e legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Kategoria e burimit të informacionit	Listë joshtruese e burimeve të informacionit
Patrullat e mbikëqyrjes së kufirit dhe aktiviteteve apo operacione të tjera të mbikëqyrjes së kufirit	- Aktivitete të përbashkëta të mbikëqyrjes së kufijve detarë, tokësorë dhe ajrorë, me vendet fqinje, duke përfshirë të gjitha raportet, planet, produktet analitike dhe platformat teknike përkatëse, që shfaqin, për shembull, vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve; - Misionet e kërkim-shpëtimit; - Aktivitetet e përbashkëta që lidhen me doganat; - Aktivitetet apo operacionet e përbashkëta të kontrollit të peshkimit.
Qendra lokale, rajonale apo qendra të tjera koordinimi	- Raporte apo informacione nga qendra ndërkombëtare të koordinimit; - Informacione nga qendrat kombëtare të koordinimit të vendeve anëtare të BE-së; - Qendrat e bashkëpunimit policor dhe doganor.
Autoritete apo sisteme të tjera, përfshirë oficerët ndërlidhës	- Ambasadat, konsullatat dhe oficerët e ndërlidhjes të vendeve të tjera të akredituara në Shqipëri; - Ambasadat, konsullatat dhe oficerët e ndërlidhjes të vendit tonë të akredituara në vende të tjera.
Verifikimet e përbashkëta kufitare (në pikat e përbashkëta të kalimit kufitar)	- Verifikimet kufitare të personave; - Verifikimet kufitare të mjeteve të transportit, bagazheve dhe objektet në posedim të personave që kalojnë kufirin; - Mjetet e mbikëqyrjes audiovizive apo të tjera, në pikat e kalimit kufitar.
Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare (<i>FRONTEX</i>)	- Shërbimet e <i>EUROSUR-it</i>; - Produktet analitike të Agjencisë (për shembull, nivelet e ndikimit të alokuara për seksionet kufitare); - Raportet e situatës të përgatitura nga Agjencia; - Operacionet e përbashkëta; - Informacion mbi mjetet dhe pajisjet e vetë Agjencisë; - Produktet e tjera të Agjencisë.
Sistemet e raportimit të mjeteve lundruese	- Sistemi i Identifikimit Automatik (AIS); - Sistemi i Monitorimit dhe Informacionit të Trafikut të Anijeve (VTMIS); - Sistemi i Dritares së Vetme Kombëtare Detare dhe Sistemi i Identifikimit dhe Gjurmimit në Distançë të Gjatë (LRIT).
Sistemet e raportimit të avionëve	Teknologjitë e Mbikëqyrjes së Aviacionit të miratuara nga ICAO.
Organizata të tjera	- Institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e BE-së; - Organizatat ndërkombëtare;
Burime të tjera	- Sisteme të tjera informacioni në përdorim nga partnerët ndërkombëtarë (kryesisht për qëllime statistikore); - Burime të hapura.



5. Raportet e situatës rajonale dhe evropiane të sigurisë kufitare hartohen e shpërndahen çdo tre muaj, përjashtimisht raportet e situatave të veçanta, të cilat kërkojnë vëmendje të veçantë nga autoritetet vendimmarrëse.

6. Procedurat standarde të punës për shkëmbimin e informacionit, në kuadër të raporteve rajonale dhe evropiane, përmbajtja dhe forma e raportit miratohen me urdhër të përbashkët të titullarëve të autoriteteve kombëtare përgjegjëse, sipas pikës 3, të nenit 28, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”.

Neni 19

Situatat e veçanta të sigurisë kufitare

1. Me qëllim mbështetjen e aktiviteteve operacionale të sigurisë kufitare, si dhe me qëllim informimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit Evropian, Qendra Kombëtare e Koordinimit, në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare harton e përditëson raporte të situatave të veçanta.

2. Raportet e situatave të veçanta hartohen mbi informacione dhe inteligjencë rreth zonave përtej kufirit shtetëror të mbledhura dhe të shkëmbyera në kuadër të aktiviteteve operacionale, veçanërisht në kuadër të bashkëpunimit dhe vendet fqinje, vendet e rajonit apo me vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

3. Raportimi mund të ketë formën e treguesve ose raporteve të ngjarjeve të vetme dhe që mbulojnë fushat e parandalimit dhe goditjes së krimit ndërkufitar, migracionit të parregullt, si dhe mbrojtjen dhe shpëtimin e jetës së migrantëve.

4. Në të njëjtën kohë, raportet mbulojnë lëvizjet dytësore të paaautorizuara, nëse ky informacion është i disponueshëm.

5. Raportet që u dedikohen lëvizjeve dytësore të paaautorizuara (ngjarje apo tregues) dhe raporteve të mbikëqyrjes së kufirit detar dhe ajror, kur është e aplikueshme, duhet, gjithashtu, të përfshijnë ngjarjet që lidhen me kërkimin e shpëtimin në det, përveç nëse ato ofrohen kur raportohen ngjarjet në kuadër të mbikëqyrjes së kufirit detar.

6. Ngjarjet e raportuara në raportet kombëtare të sigurisë kufitare duhet të vihen në dispozicion të Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe

Bregdetare, në kuadër të raporteve të situatës evropiane, të cilat duhet të ndahen brenda 24 orëve.

7. Përmbajtja e raporteve të situatave të veçanta bazohet në strukturën e raporteve të situatës evropiane, që do të thotë se informacioni mbulon të njëjtat fusha tematike.

8. Të gjitha ngjarjet që ndodhin në zonën operacionale të një operacioni të përbashkët, projekti pilot ose ndërhyrjeje të shpejtë, të koordinuar nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare, do të raportohen pranë kësaj agjencie, sipas rregullave të dakordësuara të raportimit.

9. Procedurat standarde të punës për shkëmbimin e informacionit, në kuadër të raporteve të situatave të veçanta, miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Financave dhe ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

KREU IV

KOMPONENTËT E RAPORTIMIT DHE NDIKIMI

Neni 20

Komponentët e raporteve të situatave

1. Çdo raport situatë përbëhet nga tre komponentë informacioni: komponenti i ngjarjeve, komponenti i operacioneve dhe komponenti i analizës.

2. Komponenti i ngjarjeve përbëhet nga raporte të tilla, si ngjarje dhe incidente, që lidhen me kalimet e paaautorizuara të kufirit dhe krimin ndërkufitar, dhe, kur është i disponueshëm, informacion mbi lëvizjet dytësore të paaautorizuara për qëllime të kuptimit të tendencave, vëllimeve dhe rrugëve migratore.

3. Komponenti operacional përmban informacion mbi operacionet, duke përfshirë planin e vendosjes, zonën e operacioneve dhe pozicionin, kohën, statusin dhe llojin e aseteve pjesëmarrëse, siç parashikohet në planin operacional.

4. Komponenti i analizës përmban informacion të analizuar, që është i rëndësishëm për caktimin e niveleve të ndikimit në seksionet e kufirit, si: imazhe dhe të dhëna gjeografike, zhvillime dhe tregues kryesorë, raporte analitike dhe informacione të tjera mbështetëse. Kur është i disponueshëm, përfshihet



edhe informacioni analitik, që ofron kontekst për lëvizjet dytësore të paautorizuara.

Neni 21

Komponenti i ngjarjeve

1. Për mbikëqyrjen e kufijve tokësorë, ajrorë dhe detarë, si dhe verifikimet kufitare në pikat e kalimit kufitar, autoritetet kombëtare raportojnë pranë Qendrës Kombëtare të Koordinimit, të gjitha ngjarjet që evidentohen, pavarësisht nivelit të ndikimit të ngjarjes në sigurinë kufitare. Në rastin e operacioneve të përbashkëta ose ndërhyrjeve të shpejta kufitare, raportohet sipas parashikimeve në planin operacional.

2. Me qëllim sigurimin e koherencës dhe një informacioni sa më të plotë, ngjarjet do të raportohen sipas një formati të miratuar nga drejtuesi i Qendrës.

Neni 22

Komponenti operacional

1. Komponenti operacional përbëhet, nga:

- a) raporti mbi asetet e veta;
- b) raporti mbi planet operationale;
- c) raporti mbi çështjet mjedisore.

2. Komponenti operacional përmban të dhëna dhe detajime mbi operacionet, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: planin e vendosjes së forcave dhe mjeteve, përcaktimin e zonës së operacionit dhe pozicionimin e njësive, kohëzgjatjen, statusin operacional, si dhe asetet pjesëmarrëse, në përputhje me planin operacional të miratuar.

3. Raporti mbi asetet e veta përmban informacionin e siguruar nga autoritetet kombëtare kompetente. Në rastet kur asetet angazhohen në operacione, informacioni mblidhet nga strukturat vendore pjesëmarrëse dhe raportohet pranë Qendrës Kombëtare të Koordinimit, sipas procedurave në fuqi.

4. Në rastin e operacioneve të kontrollit dhe mbikëqyrjes kufitare të kryera nga autoritetet kombëtare, këto të fundit raportojnë mbi planet operationale përkatëse. Qendra Kombëtare e Koordinimit ka të drejtë të njihet me planet operationale.

5. Raportimet përkatëse përfshihen në raportet e situatës kombëtare të sigurisë kufitare. Kur

vlerësohet e nevojshme, veçanërisht në rastet kur niveli i ndikimit në seksione të caktuara kufitare është i lartë ose kritik, planet operationale raportohen edhe në kuadër të situatës evropiane të sigurisë kufitare.

6. Përmbajtja dhe formati i raportimit për planet operationale parashikohen në procedurën standarde përkatëse.

7. Në raportimin mbi çështjet mjedisore, autoritetet kombëtare, si dhe ato të parashikuara në pikën 3, të nenit 12, të kësaj rregulloreje, mund të raportojnë informacion mjedisor, siç janë imazhet në kohë reale ose video me lëvizje të plotë të ofruara nga kamerat video, sistemet e radarëve dhe pajisjet e tjera të zbulimit, vëzhgimet meteorologjike dhe parashikimet e motit, të cilat mund të ndihmojnë në kuptimin e situatës në kufi ose në monitorimin e një operacioni specifik kufitar. Një informacion i tillë mund të jetë i dobishëm në monitorimin dhe analizimin e zhvillimit të situatës në kufi dhe në mbështetjen e planifikimit dhe vendosjes së aseteve dhe/ose personelit.

Neni 23

Komponenti analitik dhe analiza e riskut

1. Me qëllim përditësimin e komponentit të analizës së raporteve të situatave, Qendra Kombëtare e Koordinimit, dhe, kur është e nevojshme, në bashkëpunim në Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare, do të ofrojë raporte të analizës së riskut.

2. Në funksion të ciklit të inteligjencës së modelit të përbashkët të analizës së integruar të riskut, raportet e situatave hartohen përmes mbledhjes, vlerësimit, krahasimit, analizës, interpretimit, gjenerimit, vizualizimit dhe shpërndarjes së informacionit.

3. Raportet e analizës së riskut përdoren, për:

a) lehtësimin e të kuptuarit të ngjarjeve dhe incidenteve në kufi dhe, kur është e mundur, lidhjen e tyre me lëvizjet dytësore të paautorizuara, analizën dhe parashikimin e tendencave përkatëse;

b) lehtësimin e planifikimit dhe kryerjes së synuar të operacioneve të kontrollit kufitar;

c) analizën strategjike të riskut.

4. Raportet e analizës së riskut mund të marrin format e mëposhtme:



Produktet e mundshme	Përshkrimi
Zhvillimet kryesore	Raport i shkurtër që përmban një përshkrim dhe analizë koncize të ngjarjeve ose kushteve, sociale, ekonomike ose demografike, duke përfshirë situatën e të drejtave themelore, të cilat kanë ose mund të kenë ndikim në imigracionin e parregullt ose krimin ndërkufitar.
Raport informues	Një raport konciz dhe zakonisht <i>ad hoc</i> , që analizon çështje specifike të imigracionit të parregullt ose krimin ndërkufitar, i cili ka për qëllim kryesor të informojë vendimmarrësit shpejt dhe në mënyrë efektive rreth një çështjeje specifike.
Raport analitik	Një raport i rregullt dhe më i detajuar (në krahasim me raportin informues) mbi imigracionin e parregullt ose krimin ndërkufitar, që mbulon zona ose çështje specifike dhe që ofron një analizë më të thelluar të situatës dhe, nëse është e mundur, rekomandime.
Raporte të analizës së riskut të Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare	Informacion mbi situatën në vend ose në rajon, nga perspektiva e sigurisë dhe të kërcënimeve, duke përfshirë analizën e aktiviteteve kriminale të mundshme ndërkufitare.
Burime të tjera	Burime të hapura.

Neni 24

Kërkesa për informacion

1. Kërkesa për informacion ka për qëllim mbledhjen e një informacioni shtesë dhe i drejtohet nga autoritetet përdoruese të këtij informacioni nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Koordinimit, burimit të informacionit ose një përdoruesi tjetër.

2. Kur informacioni i ofruar, rreth një ngjarje të veçantë, nuk është i plotë, për të ndërtuar një pamje të situatës, të riskut apo kërcënimit ndaj sigurisë kufitare ose me qëllim plotësimin e informacionit rreth një ngjarje të veçantë, autoritetet mund të kërkojnë për informacion shtesë, e cila mund t'i drejtohet, nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Koordinimit, dy ose më shumë burimeve.

3. Kërkesa për informacion duhet të jetë domosdoshmërisht e lidhur me ngjarjen në fjalë. Një kërkesë e tillë do t'i dërgohet burimit, që ka dhënë informacionin fillestar. Nëse ofrohen informacione shtesë, Qendra Kombëtare e Koordinimit duhet të përditësojë raportin e kësaj situate ose ngjarjeje.

4. Në çdo rast, para kthimit të përgjigjes, duhet të merret dakordësia e burimit të informacionit.

Neni 25

Lista e subjekteve me interes

1. Me qëllim forcimin e kapaciteteve zbuluese të autoriteteve kombëtare, Qendra Kombëtare e Koordinimit do të krijojë dhe rifreskojë vazhdimisht listën e subjekteve me interes, të cilat, në bazë të analizës së riskut, dyshohet se mund të përfshihen në krime që kryhen në kufti. Kjo listë do të përmbajë informacion mbi asetet, sjelljet ose profilet e subjekteve.

2. Kjo listë mund të përfshijë, por jo vetëm:

- mjete lundrimi të dyshuara;
- mjete të dyshuara të transportit ajror;
- aeroporte, të dyshuara origjine, dhe vende të tjera të njohura ose të dyshuara si vende origjine të fluturimeve;
- portet e dyshuara të origjinës, vendet e pritjes dhe vende të tjera të njohura ose të dyshuara si vende origjine të trafikut detar;
- operatorë të dyshuar.

3. Kjo listë mund të përmbajë një tregues të reagimit/masave të sugjeruara, në rast të zbulimit të elementeve të lartpërmendura.



Neni 26

Sektorët e kufirit

1. Për qëllimet e raportimit rreth situatave, kufiri shtetëror do të ndahet në sektorë. Sektorët do të jenë referencë e rëndësishme për menaxhimin e integruar të kufirit, veçanërisht për analizën e riskut, planifikimin e emergjencave dhe ndërhyrjeve dhe vlerësimin e cenueshmërisë së sigurisë kufitare.

2. Të gjitha ngjarjet që raportohen do t'i përkasin një sektori të kufirit, të cilat mund të plotësohen nëpërmjet indikatorëve apo raporteve për ngjarje të veçanta. Treguesit do të mbështesin vlerësimin e zhvillimeve të përgjithshme në një sektor kufitar dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e ndërgjegjësimit për situatën, ndërsa raportet e ngjarjeve të veçanta lidhen me reagimin në kohë ndaj ngjarjeve të caktuara.

3. Sektorët kufitarë përcaktohen duke marrë në konsideratë karakteristikat gjeografike, operative dhe të riskut të kufirit, si dhe, kur është e përshtatshme, strukturën organizative dhe zonat e përgjegjësive të autoriteteve kompetente.

4. Ndarja e kufirit shtetëror në sektorë përcaktohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 27

Caktimi i nivelit të ndikimit

1. Hartuesi i një raporti ngjarjeje ose i një raporti të analizës së riskut duhet të vlerësojë nivelin e ndikimit të informacionit të raportuar në sigurinë kufitare.

2. Niveli i ndikimit duhet të pasqyrojë ndikimin e përgjithshëm të informacionit të raportuar, në:

a) zbulimin, parandalimin dhe luftën kundër migracionit të parregullt;

b) parandalimin, zbulimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar;

c) mbrojtjen dhe shpëtimin e jetës së migrantëve.

3. Hartuesi i një raporti ngjarjeje duhet t'i caktojë një nivel ndikimi çdo ngjarjeje dhe raporti të analizës së riskut.

4. Caktimi i nivelit të ndikimit do të bëhet duke u bazuar në analizën e riskut dhe vlerësimin e cenueshmërisë. Niveli i ndikimit do të bazohet në dy elemente: kërcënimin ndaj sigurisë kufitare dhe nivelin përkatës të reagimit që kërkohet.

5. Caktimi i niveleve të ndikimit për sektorët kufitarë bëhet me qëllim përmirësimin e ndërgjegjësimit për situatën, duke vlerësuar rreziqet e kërcënimit dhe forcimin e aftësive të reagimit, duke vlerësuar kapacitetet dhe duke identifikuar dobësitë.

6. Caktimi i nivelit të ndikimit do të shërbejë, për:

a) identifikimin e riskut dhe kërcënimet kryesore dhe vlerësimin e kërcënimit, që ka të ngjarë të ndodhë në një seksion kufitar;

b) evidentimin e kërcënimeve të materializuara – ngjarje që kanë ndodhur;

c) vlerësimin e kërcënimeve të mundshme – ngjarje që ka të ngjarë të ndodhin në të ardhmen e afërt.

7. Periudha kohore e vlerësuar mund të ndryshojë dhe do të varet nga konteksti.

8. Për caktimin e nivelit të ndikimit, Qendra Kombëtare e Koordinimit mund të bashkëpunojë me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare.

9. Për qëllimet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, sektorëve të kufirit do t'u caktohen katër nivele të ndikimit: i ulët, i mesëm, i lartë dhe kritik.

Neni 28

Ndikimi i ulët

1. Niveli i ndikimit “i ulët” përcaktohet në rastet kur numri i treguesve dhe i ngjarjeve të konstatuara, si dhe probabiliteti i ndodhjes së ngjarjeve në të ardhmen e afërt, paraqitet në nivel të ulët, duke reflektuar praninë e rreziqeve dhe kërcënimeve kryesore me intensitet të reduktuar.

2. Në sektorët kufitarë me nivel ndikimi “të ulët”, autoritetet kombëtare përgjegjëse për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit të jashtëm sigurojnë që personeli dhe burimet të jenë të mjaftueshme për kryerjen e aktiviteteve të rregullta të kontrollit kufitar, në përputhje me analizën e riskut.

3. Në nivel qendror, rajonal e vendor, autoritetet kombëtare identifikojnë burime rezervë, të cilat aktivizohen sipas nevojës, në përputhje me vlerësimin e situatës.

Neni 29

Ndikimi i mesëm

1. Niveli i ndikimit “i mesëm” përcaktohet në rastet kur numri i treguesve dhe i ngjarjeve të



konstatuara, si dhe probabiliteti i ndodhjes së ngjarjeve në të ardhmen e afërt paraqitet në një nivel krahasimisht mesatar, duke reflektuar praninë e rreziqeve dhe të kërcënimeve kryesore me intensitet të moderuar.

2. Nëse një sektori të kufirit i është caktuar nivel ndikimi “i mesëm”, autoritetet kombëtare duhet të forcojnë kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, duke zbatuar masa shtesë të përshtatshme. Qendra Kombëtare e Koordinimit do të njoftohet, nëse merren masa të tilla. Nëse kërkohet, Qendra Kombëtare e Koordinimit do të ofrojë mbështetje dhe do të kontribuojë në menaxhimin e burimeve dhe të personelit në atë sektor kufitar.

3. Në nivel strategjik, Qendra Kombëtare e Koordinimit do të ofrojë monitorim të situatës, analizë të rrezikut dhe kontribut në menaxhimin e burimeve dhe personelit, duke përfshirë planifikimin e rezervave.

4. Në nivel operacional e taktik, strukturat vendore, me mbështetjen e Qendrës Kombëtare të Koordinimit, do të zbatojnë masa shtesë mbikëqyrjeje dhe do të kryejnë aktivitete të intensifikuara të kontrollit kufitar, veçanërisht në zonat e identifikuar si kritike brenda seksionit kufitar.

5. Me mbështetjen e Qendrës Kombëtare të Koordinimit, strukturat vendore do të mundësojnë rishpërndarjen dhe zhvendosjen e shpejtë të burimeve dhe të personelit brenda sektorit kufitar.

6. Strukturat vendore do të informojnë rregullisht Qendrën Kombëtare të Koordinimit për masat e marra.

Neni 30

Ndikimi lartë

1. Niveli i ndikimit “i lartë” përcaktohet në rastet kur numri i treguesve dhe i ngjarjeve të konstatuara, si dhe probabiliteti i ndodhjes së ngjarjeve në të ardhmen e afërt, rezultojnë në një nivel krahasimisht të lartë, duke përfshirë praninë e rreziqeve dhe kërcënimeve kryesore me intensitet të shtuar.

2. Nëse një seksioni të kufirit i është caktuar nivel i lartë ndikimi, autoritetet kombëtare duhet të sigurojnë që strukturat vendore përgjegjëse për menaxhimin e kufirit, në atë sektor, të marrin mbështetjen e nevojshme dhe që masat e kontrollit e të mbikëqyrjes së kufirit të forcohen, në përputhje me nivelin e riskut dhe kërcënimit të identifikuar.

3. Në rastet e nivelit të lartë të ndikimit, autoritetet kombëtare mund të kërkojnë rialokimin e përkohshëm të burimeve njerëzore dhe logjistike nga strukturat vendore, që mbulojnë sektorë të tjerë të kufirit me nivel të ulët ndikimi, nga njësitë speciale ose nga struktura të tjera shtetërore.

4. Për të adresuar nevojat në situata të ndikimit të lartë, Qendra Kombëtare e Koordinimit duhet të ketë një pasqyrë të përgjithshme të burimeve dhe personelit të vendosur në secilin sektor kufitar dhe një pasqyrë të burimeve dhe personelit shtesë të disponueshëm në nivel kombëtar, të cilat mund t’u ofrohen sektorëve kufitarë me një nivel të lartë ndikimi.

5. Qendra Kombëtare e Koordinimit duhet të kontribuojë në menaxhimin efikas të burimeve logjistike dhe personelit, si dhe të mbështesë koordinimin, planifikimin dhe zbatimin e kontrollit kombëtar të kufijve.

6. Strukturat vendore do të informojnë rregullisht Qendrën Kombëtare të Koordinimit për masat e marra.

7. Në rastet e situatave me nivel të lartë të ndikimit njoftohet menjëherë ministri i Punëve të Brendshme.

Neni 31

Ndikimi kritik

1. Niveli i ndikimit “kritik” caktohet, kur, me gjithë masat e marra në nivel kombëtar, numri i treguesve, ngjarjeve që kanë ndodhur, ngjarjeve që ka të ngjarë të ndodhin në të ardhmen e afërt dhe riskut e kërcënimit kryesore janë krahasimisht të paprecedente dhe potencialisht mund të cenojnë sigurinë kombëtare të vendit ose të vendit fqinj.

2. Në rastet e situatave me nivel kritik të impaktit njoftohet menjëherë ministri i Punëve të Brendshme.

3. Në rastet e nivelit kritik të impaktit, në zbatim të marrëveshjeve një fuqi, autoritetet kombëtare mund të kërkojnë mbështetje nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare.

Neni 32

Vlerësimi i ndikimit të caktuar

1. Qendra Kombëtare e Koordinimit dhe, kur vlerësohet e nevojshme, në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe



Bregdetare, do të vlerësojë caktimin e niveleve të ndikimit nga strukturat vendore dhe masat e marra në nivel vendor ose kombëtar.

2. Koha e reagimit do të jetë një masë e përshtatshme për vlerësimin e aftësisë së reagimit. Në nivel taktik, kjo do të jetë koha e nevojshme për të përpunuar një alarm të mundshëm, për të zhvendosur burimet njerëzore dhe logjistike, dhe për të përballur situatën në kufi, duke filluar nga momenti i caktimit të nivelit të impaktit deri kur të gjitha burimet e kërkuara janë në vend dhe të gjitha përgatitjet operationale kanë përfunduar.

Neni 33

Përditësimi i raporteve të situatës

1. Raporti kombëtar i sigurisë kufitare dhe raportet e situatave të veçanta do të jenë pronë e Qendrës Kombëtare të Koordinimit dhe do të përditësohen nga kjo qendër.

2. Qendra Kombëtare e Koordinimit mund të ndajë, në nivel ndërkombëtar, informacion rreth situatave të veçanta, i cili lidhet vetëm me territorin e vendit tonë dhe jo duke mbuluar informacione rreth një vendi tjetër, nëse kjo nuk është rënë dakord paraprakisht apo nëse nuk është përcaktuar në raportin e situatës së veçantë.

3. Qendra Kombëtare e Koordinimit do të jetë përgjegjëse, për:

a) përpunimin e çdo raporti të marrë, nga autoritetet kombëtare apo autoritetet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 12, të kësaj rregulloreje, në kohën e duhur, me qëllim përditësimin në kohë të raporteve përkatëse të situatave;

b) krijimin dhe përditësimin e komponentit të ngjarjeve të raporteve të situatës, gjenerimin dhe përditësimin e ngjarjeve në këtë komponent dhe caktimin e nivelit përkatës të ndikimit;

c) krijimin dhe përditësimin e komponentit operacional të raporteve të situatës bazuar në raportet mbi asetet e veta dhe në planet e operationeve;

ç) krijimin dhe përditësimin e komponentit të analizës së raporteve të situatës, bazuar në raportet e analizës së riskut dhe caktimin e një niveli përkatës të ndikimit;

d) krijimin dhe përditësimin e lidhjeve ndërmjet elementeve të ndryshme të raporteve të situatës, duke marrë parasysh lidhjet ekzistuese në raporte;

dh) menaxhimin e aksesit të përdoruesve të raporteve përkatëse të situatës dhe sigurinë e të dhënave;

e) transmetimin e raporteve përkatëse dhe informacionit të nevojshëm tek autoritetet kombëtare;

ë) administrimin dhe fshirjen e informacionit, në përputhje me politikën përkatëse të të dhënave.

Neni 34

Kontrolli i cilësisë së të dhënave

1. Qendra Kombëtare e Koordinimit është përgjegjëse për kontrollin e cilësisë së të dhënave dhe raportimeve.

2. Me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së të dhënave dhe raportimeve, Qendra Kombëtare e Koordinimit do të bazohet në indikatorët e mëposhtëm:

a) Numrin dhe frekuencën e raportimeve për çdo sektor kufitar dhe pikë kalimi kufitar;

b) Kohën e raportimit;

c) Plotësimin e kërkesave dhe qëndrueshmërinë e raporteve.

3. Indikatorët do të përdoren:

a) për të monitoruar statusin e komponentëve teknikë të Sistemit, në kohë reale;

b) për të mbështetur identifikimin e reagimit nga ngjarje dhe dështime të mundshme në funksionimin e Sistemit;

c) për të garantuar sigurinë e të dhënave.

KREU V

SIGURIA E TË DHËNAVE

Neni 35

Rrjeti i komunikimit

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, autoritetet e parashikuara në nenin 12 do të shkëmbejnë informacion nëpërmjet kanaleve të sigurta dhe të autorizuar të komunikimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe infrastrukturës teknike të disponueshme për secilin autoritet.

2. Shkëmbimi i informacionit bëhet në përputhje me nivelin e certifikimit të sigurisë të rrjetit të komunikimit.

3. Për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar mbi nivelin e certifikimit të rrjetit zbatohen rregullat



e parashikuara për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

Neni 36

Aksesi në sistemet dhe bankat e të dhënave

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, për të mundësuar shkëmbimin e informacionit, në kohë thuajse reale, punonjësit e autoriteteve kombëtare të përcaktuara në pikën 1, të nenit 12, do të kenë akses në sistemet dhe bankat e të dhënave të këtyre autoriteteve.

2. Niveli i aksesit përcaktohet nga titullarët e autoriteteve kombëtare bazuar në parimin “nevojë për njohje”.

Neni 37

Kategoritë e të dhënave

1. Në zbatim të kësaj rregulloreje, autoritetet kombëtare përpunojnë të dhëna dhe informacione të nevojshme për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, menaxhimin e integruar të kufirit, analizën e riskut, koordinimin ndërinstucional dhe shkëmbimin e informacionit me autoritetet kombëtare vendase, dhe të huaja, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kategoritë e të dhënave që përpunohen përfshijnë:

a) të dhëna mbi ngjarjet, incidentet dhe situatat e konstatuara në kufi;

b) të dhëna operative të mbledhura gjatë aktiviteteve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit;

c) të dhëna mbi mjetet, pajisjet, sistemet dhe infrastrukturën e përdorur për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit;

ç) të dhëna statistikore, analitike dhe të vlerësimit të riskut;

d) të dhëna personale në masën që përpunimi i tyre është i nevojshëm për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë rregullore dhe i autorizuar nga legjislacioni në fuqi.

2. Përpunimi, ruajtja, transmetimi dhe mbrojtja e të dhënave kryhen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë kibernetike, informacionin e klasifikuar dhe aktet e tjera të zbatueshme në fuqi.

Neni 38

Komunikimi ndërkombëtar

1. Komunikimi ndërmjet Qendrës së Kombëtare të Koordinimit me autoritetet ndërkombëtare do të realizohet nëpërmjet kanaleve të sigurta të komunikimit, si më poshtë:

a) rrjete të sigurta qeveritare;

b) platforma të sigurta ndërkombëtare;

c) *email* i enkriptuar;

ç) sisteme të menaxhimit të incidenteve;

d) linja të siguruara telefonike/videokonferenca të enkriptuara;

dh) sisteme të shkëmbimit të dokumenteve të klasifikuara.

2. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit, për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të kryhet sipas parashikimeve të marrëveshjeve dy- dhe/ose shumëpalëshe.

3. Komunikimi me autoritetet ndërkombëtare do të realizohet në gjuhën angleze.

Neni 39

Siguria e rrjetit të komunikimit dhe sistemeve

1. Autoritetet kombëtare të përcaktuara në pikën 1, të nenit 12, të kësaj rregulloreje, janë përgjegjëse për funksionimin e sigurinë e rrjetit të komunikimit dhe sistemeve.

2. Autoritetet kombëtare do të caktojnë një punonjës/oficer për sigurinë dhe funksionimin e rrjetit të komunikimit, të cilëve u delegohen detyra që lidhen me sigurinë e funksionimin e rrjetit të komunikimit në kuadër të Sistemit të Mbikëqyrjes së Kufirit.

3. Përgjegjësitë e oficerëve të sigurisë përcaktohen me urdhër të përbashkët ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Financave dhe të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 40

Pika e kontaktit *EUROSUR*

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, Qendra Kombëtare e Koordinimit do të luajë rolin e pikës së kontaktit *EUROSUR*.

2. Për kryerjen e rolit të pikës së kontaktit *EUROSUR*, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit do të emërojë, pranë Qendrës Kombëtare të



Koordinimit, oficerë policie, me njohuri të mira të gjuhës angleze.

3. Qendra e Koordinimit *EUROSUR* do të jetë funksionale 24 orë në 7 ditës të javës.

4. Shkëmbimi i informacionit në kuadër të *EUROSUR-it* do të kryhet sipas parashikimeve të marrëveshjes së punës ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (*FRONTEx*) ose të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për aktivitetet operacionale të kryera nga Agjencia e Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e Shqipërisë ose të planeve operacionale të operacioneve të përbashkëta.

Neni 41

Siguria fizike

1. Në Qendrën Kombëtare të Koordinimit, Policia e Shtetit do të zbatojë masat e sigurisë fizike që parashikohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

2. Masat minimale do të përfshijnë:

a) në zonat administrative:

i. vendosjen e një perimetri të përcaktuar dukshëm për kontrollet e individëve dhe, kur është e mundur, të automjeteve;

ii. hyrjen pa shoqërim, që duhet t'u lejohet vetëm individëve që janë të autorizuar në përputhje me politikën përkatëse të brendshme të Policisë së Shtetit;

iii. të gjithë individët e tjerë, që duhet të shoqërohen në çdo kohë ose t'u nënshtrohen kontrolleve ekuivalente;

b) në zonat e sigurisë:

i. duhet të vendoset një perimetër i përcaktuar dukshëm dhe i mbrojtur përmes të cilit të gjitha hyrjet e daljet kontrollohen me anë të pajisjeve të kontrollit të aksesit;

ii. për vizitorët, të cilëve nuk u sigurohet akses kontrolli, do të regjistrohen në një regjistër të veçantë, ku shënohet ora e hyrjes dhe e daljes, arsyetja e vizitës dhe personi me të cilin do të takohen;

iii. hyrja pa shoqërim do t'u lejohet vetëm individëve që janë të certifikuar posaçërisht dhe janë të autorizuar posaçërisht për të hyrë në zonë në bazë të "nevojës për njohje";

iv. të gjithë individët e tjerë do të shoqërohen në çdo kohë ose t'u nënshtrohen kontrolleve ekuivalente.

Neni 42

Komunikimi me publikun

Me qëllim informimin e publikut, Qendra Kombëtare e Koordinimit do të ketë faqen e saj zyrtare, ku do të pasqyrohen informacione dhe kuadri ligjor, nënligjor, në gjuhën shqipe dhe angleze, që lidhen me qarkullimin ndërkufitar të shtetasve dhe mallrave.

VENDIM

Nr. 680, datë 11.9.2026

**PËR MIRATIMIN E VËNIES NË
DISPOZICION TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE NR.
178/44, NR. 152/43 DHE NR. 182, NË
ZONËN KADASTRALE 1522, BASHKIA
DURRËS, NË ZONAT ME PËRPARËSI
ZHVILLIMIN E TURIZMIT, ME
TARIFËN SIMBOLIKE 1 EURO, NË
MBËSHTETJE TË INVESTIMIT
STRATEGJIK NË FUSHËN E
TURIZMIT, SI DHE PËR MIRATIMIN E
PROJEKTMARRËVESHJES NDËRMJET
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT DHE SHOQËRISË
“OMNIX ALBANIA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 35 e 36, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe në vijim të kërërve I, pika 4.2, dhe IV, pika 2, të vendimit nr. 162, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 691, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formatit të marrëveshjes me investitorët në fushën e turizmit”, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

HYRJE

1. Miratimin e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 178/44, nr. 152/43 dhe nr. 182, në zonën kadastrale 1522, Bashkia Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme 90 030 (nëntëdhjetë mijë e tridhjetë) m², në pronësi shtetërore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në favor të shoqërisë “OMNIX Albania” sh.p.k., në mbështetje të investimit strategjik në fushën e turizmit.

2. Miratimin e lidhjes së marrëveshjes së përdorimit me tarifë simbolike 1 euro ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe shoqërisë “OMNIX Albania” sh.p.k., sipas tekstit të projekt marrëveshjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe shoqëria “OMNIX Albania” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

MARRËVESHJE

PËR INVESTIMIN NË TURIZËM

Kjo marrëveshje nënshkruhet sot, më _____._____, ndërmjet palëve:

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, përfaqësuar nga _____, në cilësinë e përfaqësuesit të ministrisë, sipas [akti ose vendimi i autorizimit nga ministri/Sekretari i Përgjithshëm] (më tej “**Ministria**”); dhe

Shoqëria “OMNIX Albania” sh.p.k., themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me seli në Durrës, Gjiri i Lalëzit, Durrës, Shqipëri, me numër regjistrimi unik të subjektit NUIS: **K81527005D**, përfaqësuar nga z. Skender Madani, lindur më _____ dhe banues në _____, identifikuar me letërnjoftimin nr. _____, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor (më tej “**Investitori**”).

A. Me vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 22/9, datë 18.7.2022, Investitori ka marrë statusin e Investimit/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë për projektin e investimit “Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit” i cili konsiston në një kompleks luksoz që përfshin një park rezidencial, një bulevard, një hotel me 5 yje, park ujqor, klub fëmijësh, klub plazhi etj. (me tej “**Projekti**”);

B. Në zbatim të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar dhe në mbështetje të vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 22/9, datë 18.7.2022, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 2.3.2016, “Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit”, të ndryshuar, është miratuar vënia në dispozicion të Investitorit e pasurive shtetërore, duke i dhënë të drejtën e përdorimit të tyre, me sipërfaqe prej 90.030 m², e cila përfshin pasuritë me nr. 178/44, 152/43 dhe 182, zona kadastrale 1522, të ndodhura në Durrës, Gjiri i Lalëzit, Durrës (Pasuria);

C. Në zbatim të vendimit të KIS-së nr. 22/9, datë 18.7.2022, “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit “Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit”, me subjekt “OMNIX Albania” sh.p.k., NUIS: K81527005D dhe të neni 29, “E drejta e përdorimit të brigjeve”, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, brigjet e detit, si dhe të zonës përkatëse të plazhit në kufijtë e zhvillimit, do t’i jepen subjektit në përdorim me qira, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 153, datë 11.3.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modelit tip të marrëveshjes, që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe investitorit, për përdorimin e brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si stacione plazhi”;

D. Në këmbim të marrjes në përdorim të pronës së paluajtshme shtetërore, investitori do të ndërtojë dhe zhvillojë në të dhe në pronat kufitare në pronësi të investitorit, projektin në përputhje me lejen përkatëse të ndërtimit, vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 22/9, datë 18.7.2022, si edhe në përputhje me ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar;



E. Kjo Marrëveshje lidhet në përputhje me ligjin nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 22/9, datë 18.7.2022 dhe akteve nënligjore përkatëse, përfshirë vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 2.3.2016, dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 5.10.2016, “Për miratimin e marrëveshjes tip me investitorët në turizëm”.

Në bazë të sa më sipër, palët bien dakord për të drejtat dhe detyrimet që lindin nga kjo marrëdhënie, si më poshtë:

1. PËRKUFIZIME

1.1 Kurdoherë që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë anekset e saj), për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

“Marrëveshje” – kjo marrëveshje, përfshirë të gjitha anekset e saj, nëse ka, të cilat konsiderohen se përbëjnë pjesë integrale e të pandashme të saj.

“Ministri” – ministri përgjegjës për fushën e turizmit.

“Autorizim” – çdo miratim, leje, licencë, autorizim, certifikatë, akt tjetër administrativ, që akordon të drejta, lëshimi ose rinovimi i të cilave është përgjegjësi e çdo organi administrativ të administratës shtetërore, qendrore dhe/ose lokale, dhe që është i nevojshëm për zbatimin e kësaj marrëveshjeje nga investitori.

“Ditë pune” – të gjitha ditët e javës, përveç të shtunës, të dielës dhe ditëve të festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë (për çdo paqartësi gjatë zbatimit të marrëveshjes).

“Pretendime” – në lidhje me një palë, të gjitha kërkimet, paditë, sanksionet e aplikuara, procedimet ligjore, pretendimet, vlerësimet, vendimet, zhdëmtimet, kushtet penale, gjobat, detyrimet, kërkesat, shpenzimet, shpenzimet e arsyeshme faktike të çdo lloji, duke përfshirë tarifat e arsyeshme ligjore, si dhe humbjet e shkaktuara ose të pësuar nga pala, duke përfshirë edhe fitimin e munguar.

“Njoftim për zgjidhje” – njoftimi i dhënë nga palët, sipas nenit 39.

“Faza e ndërtimit” – periudha kohore nga data e parashikuar në nenin 18.1 më poshtë, deri në datën e përfundimit të punimeve.

“Sigurim i marrëveshjes” – nënkupton garanci financiare të vendosur nga investitori në vlerën 10%

të vlerës së investimit që do të zhvillohet mbi pasurinë, objekt i kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me nenin 8, pika 4, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, për garantimin e përmbushjes në kohë dhe me cilësi të detyrimeve të investitorit sipas kësaj Marrëveshjeje. Sigurimi i Marrëveshjes mund të paraqitet në formën e garancisë bankare, policës së sigurimit ose të instrumenteve të tjera financiare të pranueshme sipas legjislacionit në fuqi.

“Punime ndërtimi” – të gjitha punimet që nevojiten për ndërtimin dhe vënien në funksionim të projektit mbi pasurinë, në përputhje me Projektin e miratuar, lejet dhe dokumentacionin teknik përkatës, duke përfshirë, por pa u kufizuar, punimet për infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e Projektit, si: infrastruktura rrugore, rrjeti i furnizimit me ujë, rrjeti i kanalizimeve për ujërat e zeza dhe të bardha, rrjeti i furnizimit me energji elektrike, shërbimet e telekomunikimit dhe të furnizimit me gaz, pa krijuar në vetvete detyrime financiare ose infrastrukturore për Ministrinë, përveç rasteve kur këto janë parashikuar shprehimisht në Marrëveshje.

“Kontroll i investitorit” – i përdorur si emër ose folje, nënkupton kontrollin e investitorit nga pjesëmarrësit në kapitalin e tij, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

“Projekt i detajuar” – projekti i detajuar, në lidhje me ndërtimin e Projektit i cili paraqitet nga investitori në kërkesën e tij për lejet e ndërtimit.

“Legjislacioni mjedisor” – legjislacioni për mjedisin, duke përfshirë ligjet që kanë të bëjnë me përdorimin e tokës, planifikimin, vlerësimin mjedisor, trashëgiminë mjedisore, ujin, ujëmbledhësit, lumenjtë, detin, shtretërit e detit, bregun e detit, plazhet, ajrin, tokën, ujërat nëntokësore ose ujin, zhurmën, tokën, përdorimin e kimikateve, substancat e rrezikshme, shtresën e ozonit, mbetjet, mallrat e rrezikshme, rregulloren e ndërtimit, zënien e ndërtesave, shëndetin publik, shëndetin dhe sigurinë në punë, rrezikun mjedisor dhe aspekte të tjera të mbrojtjes së mjedisit, të rregulluara me akte nënligjore dalë në zbatim të këtyre ligjeve.

“Rast i mospërmbushjes së detyrimit” – ka kuptimin e parashtruar në nenin 39.

“Kontrata e financimit” – nënkupton marrëveshje kredie ose financimi, të nënshkruar nga investitori me palë financuese, në lidhje me



financimin e projektimit, prokurimit, ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Projektit (ku financimi mund të ndahet në faza sipas zhvillimit me faza) dhe për ushtrimin e të drejtave të investitorit, duke përfshirë çdo modifikim, plotësim, zgjerim, rinovim dhe zëvendësim të një financimi të tillë.

“Pala financuese” – çdo person fizik apo juridik që i jep financim, borxh, hua ose rifinancim investitorit, për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Projektit dhe ushtrimin e të drejtave të investitorit, si dhe pasardhësve e përfituesve të tyre të lejuar, duke përfshirë çdo agjent ose administrues të besuar për atë person ose persona.

“Ngjarje e forcës madhore” – ka kuptimin e përcaktuar në nenin 37.

“Faza e operimit” – periudha kohore që ka kaluar nga fillimi i kësaj faze, sipas afatit të përcaktuar në nenin 29, deri në fund të afatit të Marrëveshjes.

“Projekti” – nënkupton projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen e projektit të investimit “Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit” i cili konsiston në një kompleks luksoz që përfshin një park rezidencial, një bulevard, hotel me 5 yje, park ujqor, klub fëmijësh, klub plazhi etj., miratuar me vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 22/9, datë 18.7.2022, i cili zhvillohet pjesërisht mbi pasurinë, në përputhje me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje. Për të evituar çdo paqartësi, me termin “Projekt” do të nënkuptohet projekti përfundimtar i investimit “Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit” që do të zhvillohet nga investitori siç do të miratohet nga organet përkatëse të zhvillimit të territorit.

“Forcë madhore e tejzgjatur” – ka kuptimin sipas nenit 39.1.

“E drejta e kalimit” – e drejta e kalimit mbi/nën dhe e hyrjes e daljes për/nga pasuria dhe çdo pjesë e saj pa ndërhyrje të panevojshme nga një palë e tretë, për qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

“Afati” – kohëzgjatja e kësaj kontrate për një periudhë prej 99 vitesh nga data e hyrjes në fuqi, për sa kohë që kjo Marrëveshje nuk do të mbarojë më parë ose do të shtyhet, në përputhje me parashikimet e saj.

“Pasuri” – pasuria e paluajtshme që i vihet në dispozicion investitorit sipas ligjit “Për turizmin”, e identifikuar në nenin 3.3 më poshtë.

“Struktura akomoduese” – struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendas apo të huaj, individë

ose të organizuar në grupe, për një periudhë kohe të pacaktuar, por jo më shumë se 1 (një) vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim, pije dhe shërbime të tjera).

“Punime” – çdo përgatitje toke, ndërtim dhe punime rehabilitimi (në shkallën e zbatueshme) që duhet të kryhen në pasuri.

2. INTERPRETIMI

2.1 Për sa kohë që konteksti i kësaj Marrëveshjeje nuk e kërkon ndryshe:

i. fjalët e çdo gjinie, përfshijnë gjininë e njëra-tjetrës;

ii. fjalët që përdorin numrin njëjës ose shumës, gjithashtu, përfshijnë numrin shumës ose njëjës, përkatësisht, përveç kur përjashtohet shprehimisht pjesa hyrëse dhe anekset;

iii. dokumentet dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje do të formojnë pjesë përbërëse të saj dhe të pandashme të saj;

iv. referencat ndaj çdo miratimi përfshijnë çdo ndryshim ose rimiratim dhe çdo rregull ose rregullore, të bërë sipas atij miratimi;

v. kurdoherë që kjo Marrëveshje i referohet një numri “ditësh”, ky numër do t’u referohet ditëve kalendarike, nëse ditët e punës nuk specifikohen;

vi. çdo referencë ndaj një “muaji” ose “viti” do të interpretohet si referencë ndaj një muaji ose viti kalendarik;

vii. në rast të ndonjë mospajtueshmërie ndërmjet ndonjë fjale me shkronja kapitale, termi të përkufizuar, fraze ose shkurtimi të përcaktuar në nenin 1 dhe në çdo dispozitë, fjalë, term, frazë ose shkurtimi me shkronja kapitale të përcaktuar në ndonjë aneks, shtojcë ose bashkëlidhje, kuptimi i përcaktuar në atë aneks, shtojcë ose bashkëlidhje do të ketë përparësi mbi kuptimin e përcaktuar në nenin 1, për sa kohë që konteksti i kësaj Marrëveshjeje nuk e kërkon ndryshe;

viii. në rast të një konflikti ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të saj, përparësi kanë, sipas kësaj hierarkie: dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, më pas anekset që përbëjnë pjesë integrale të saj dhe, në vijim, dokumentacioni i Projektit, i miratuar nga autoritetet kompetente, për aq sa ky i fundit nuk bie në kundërshtim me Marrëveshjen dhe anekset e saj. Për çështje të caktuara të rregulluara në mënyrë të posaçme në një aneks, ky i fundit prevalon vetëm nëse një përparësi e tillë është përcaktuar shprehimisht në Marrëveshje;



ix. titujt e neneve dhe kapitujve në këtë kontratë dhe tabela e lëndës vendosen për lehtësi e vetëm për qëllime reference dhe nuk ndikojnë në ndonjë mënyrë interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

3. OBJEKTI I MARRËVESHJES

3.1 Me anë të kësaj Marrëveshjeje palët përcaktojnë kushtet me të cilat ministria i jep investitorit të drejtën për të përdorur pasurinë dhe investitori merr përsipër që të përdorë pasurinë për të ndërtuar, zhvilluar dhe operuar pjesën takuese të Projektit të miratuar nga Komiteti i Investimeve Strategjike si një projekt strategjik.

3.2 Investitori do të përdorë pasurinë vetëm për përmbushjen e objektit të kësaj Marrëveshjeje.

3.3 Sipas përkufizimit të dhënë në parashtrësën B në deklaratat hyrëse të kësaj Marrëveshjeje, pasuria përfshin parcelat e mëposhtme:

a) Pasuria nr. 152/43, vol. 7, f. 101, zona kadastrale nr. 1522, Draç, indeks harte K-.34-88(97-B) e llojit Ranishte me sipërfaqe 24,730 m² (njëzetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë metër katrorë).

b) Pasuria nr. 178/44, vol. 5, faqe 80, zona kadastrale nr. 1522, Draç, indeks harte K-.34-88(97-B) e llojit pyll me sipërfaqe 5,400 m² (pesë mijë e katërqind metër katrorë).

c) Pasuria nr. 182, vol. 2, faqe 159, zona kadastrale nr. 1522, Draç, indeks harte K-34-88(90-D), e llojit ranishte me sipërfaqe 59,900 m² (pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind metër katrorë).

4. TARIFA PËR PËRDORIMIN E PASURISË

4.1 Në këmbim të dhënies në përdorim të pasurisë, me qëllim realizimin e Projektit të miratuar, investitori duhet t'i paguajë ministrisë tarifën simbolike 1 (një) euro, në përputhje me vendimin nr. 162, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi për zhvillimin e turizmit", i ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimit nr. 22/9, datë 18.7.2022, të Komitetit të Investimeve Strategjike.

4.2 Pagesa do të kryhet brenda 10 ditësh, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, sipas udhëzimeve që do të jepen nga ministria.

5. INVESTITORI

5.1 Palët bien dakord se Projekti do të realizohet nga investitori dhe ai do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshjeje.

6. KUSHTET PARAPRAKE

6.1 Data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje do të jetë data kur të gjitha kushtet e mëposhtme do të jenë plotësuar:

6.1.1 Investitori, brenda një afati prej 9 muajsh nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, plotëson dhe i dorëzon ministrisë dokumentet e mëposhtme:

i. dokumentacionin përkatës, në lidhje me financimin e Projektit (p.sh.: shprehje interesi për kreditim nga banka të nivelit të dytë, kontratë kredie apo dokumente që vërtetojnë kapacitetin dhe angazhimin financiar të ortakëve, rritjes së kapitalit të investitorit etj.);

ii. dokumentin që vërteton pagesën, sipas nenit 4, më lart;

iii. dokumentacionin në lidhje me sigurimin e Marrëveshjes, sipas përkufizimit të përcaktuar në nenin 1.1 të kësaj Marrëveshjeje;

iv. dokumentacionin për sigurimin e punimeve;

v. marrëveshjet e nënshkruara me nënkontraktorët (nëse do të ketë).

6.2 Brenda 10 ditësh nga plotësimi i kushtit të fundit sipas nenit 6.1 më sipër, palët do të nënshkruajnë një dokument ku deklarojnë se kushtet paraprake janë plotësuar dhe data e nënshkrimit të këtij dokumenti do të konsiderohet si data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

7. AFATI I MARRËVESHJES

7.1 Kjo Marrëveshje lidhet për një afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjetësh, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, në përputhje me vendimin nr. 22/9, datë 18.7.2022, të Komitetit të Investimeve Strategjike, si dhe legjislacionin në fuqi për vënien në përdorim të pasurisë shtetërore për investime strategjike dhe turistike. Afati 99-vjeçar dhe vënia në dispozicion e pasurisë fillojnë vetëm pas plotësimit të kushteve paraprake dhe hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

8. MARRJA NË DORËZIM E PASURISË

8.1 Marrja në dorëzim e pasurisë do të bëhet brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi, pas paraqitjes dhe verifikimit paraprak nga ministria të vlefshmërisë së sigurimit të marrëveshjes, dhe të dyja palët do të nënshkruajnë një procesverbal të marrjes në dorëzim bashkë me një plan rievimi topografik të pasurisë, ku të përcaktohen koordinatat e sakta të saj, i cili do të konsiderohet pjesë e kësaj Marrëveshjeje, si aneksi 1. Investitori ka detyrimin të



regjistrojë këtë Marrëveshje, së bashku me anekset e saj në drejtorinë vendore përkatëse të kadastrës.

9. AUTORIZIMET DHE LEJET

9.1 Investitori detyrohet të marrë të gjitha masat për marrjen e lejeve dhe autorizimeve përkatëse për realizimin e Projektit, të parashikuara dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe, veçanërisht, ato të parashikuara dhe në përputhje me legjislacionin për planifikimin e territorit, të mbrojtjes së mjedisit, si dhe me legjislacionin përkatës për turizmin. Çdo vonesë, në lidhje me marrjen e autorizimeve dhe lejeve për shkak të mos plotësimit me faj të dokumentacionit nga ana e investitorit do të konsiderohet si vonesë e shkaktuar nga ky i fundit.

9.2 Ministria do të japë të gjithë ndihmesën e arsyeshme, e cila mund të jetë e nevojshme kundrejt investitorit për sa i përket detyrimit të paragrafit 9.1. Gjithsesi, kjo dispozitë nuk interpretohet dhe nuk nënkupton asnjë detyrim të posaçëm të ministrisë për të garantuar marrjen e autorizimeve dhe lejeve të lartpërmendura nga ana e investitorit dhe asnjë të drejtë të tij në lidhje me këtë.

10. NDRYSHIMI I KONTROLLIT DHE KUFIZIMET E TRANSFERIMEVE

10.1 Çdo ndryshim apo transferim i kontrollit të kapitalit të investitorit, si dhe çdo transferim i veprimtarisë, si dhe të drejtave dhe detyrimeve objekt i kësaj Marrëveshjeje drejt palëve të treta, të ndryshme nga investitori, duhet të miratohet paraprakisht nga ministri, i cili duhet ta japë atë brenda 10 ditësh pune, në rastin kur investitori paraqet dokumentacion të mjaftueshëm për të provuar në mënyrë të arsyeshme se gjendja financiare, ekonomike dhe ligjore e investitorit nuk do të pësojë ndryshime materiale si rrjedhojë e ndryshimit, si dhe me kusht që objekti i veprimtarisë dhe pasuria nuk do të pësojnë ndryshime.

11. NËNKONTRAKTORËT

11.1 Investitori do të ndryshojë marrëveshjet me nënkontraktorët kryesorë që do të realizojnë ndërtimin e Projektit, lidhur me atë pjesë të Projektit që do të zhvillohet mbi pasurinë, vetëm pasi të ketë marrë miratimin paraprak dhe me shkrim nga ministria. Ministria duhet të japë një përgjigje me shkrim, brenda 5 ditëve pune nga dita e kërkesës për miratim nga ana e investitorit, së cilës duhet t'i bashkëlidhet edhe një kopje e draftmarrëveshjes përfundimtare me nënkontraktorin, si dhe të dhënat për nënkontraktorin. Ministria mund ta vonojë ose

refuzojë miratimin vetëm për arsye të mbrojtjes së interesit publik dhe pasurisë, në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje. Angazhimi ose zëvendësimi i nënkontraktorëve kryesorë kryhet vetëm pas marrjes së këtij miratimi paraprak dhe me shkrim. Në çdo rast, mungesa e përgjigjes nga ministria brenda afatit të mësipërm nuk do të konsiderohet si miratim i dhënë.

11.2 Investitori do të jetë përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe të realizimit të Projektit, lidhur me atë pjesë të Projektit që do të zhvillohet mbi pasurinë pavarësisht angazhimit të nënkontraktorëve.

12. TË DREJTAT E MINISTRISË

12.1 Përveç sa parashikohet në dispozita të tjera të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi, ministria do të ketë të drejtat e mëposhtme:

a) e drejta e përfitimit të tarifës për dhënien në përdorim të pasurisë, sipas nenit 4;

b) e drejta për të ushtruar mbikëqyrje, inspektime dhe kontrole, në lidhje me realizimin e punimeve në përputhje me grafikun e punimeve, skicat, planimetritë, vlerën dhe fazat e investimit si pjesë të Projektit të miratuar nga ministria;

c) e drejta për të ushtruar mbikëqyrje, inspektime dhe kontrole, në lidhje me përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin e turizmit për llojin e veprimtarisë turistike që zhvillohet në bazë të Projektit;

ç) e drejta për të ushtruar mbikëqyrje, inspektime dhe kontrole, në lidhje me zbatueshmërinë e kushteve të kësaj Marrëveshjeje nga investitori, si dhe në lidhje me mosndryshimin e objektit të veprimtarisë së ushtruar, si dhe të pasurisë, nga ana e tij, e nënkontraktorëve;

d) e drejta për të marrë në dorëzim nga investitori pasurinë, pas përfundimit të afatit ose në rastet e zgjidhjes paraprake të Marrëveshjes.

13. DETYRIMET E MINISTRISË

13.1 Pavarësisht nga ndonjë parashikim tjetër në këtë Marrëveshje ose ndonjë detyrim tjetër që do të përmbushet nga ministria sipas kësaj Marrëveshjeje, ministria ka për detyrë që:

a) të lëshojë, përtërijë ose zgjatë të gjithë certifikatat apo autorizimet e parashikuara nga legjislacioni për turizmin, për lëshimin e të cilave është kompetente ministria, në lidhje me veprimtarinë e ushtruar sipas Projektit, nëse



investitori i përmbush kushtet ligjore për dhënien e tyre;

b) t'i japë investitorit ndihmesë dhe asistencë të tillë që investitori, në mënyrë të arsyeshme, mund të kërkojë për dhënien, përtëritjen ose zgjatjen nga investitori të lejeve apo autorizimeve, apo regjistrimeve, të kërkuara për ushtrimin e veprimtarisë së investitorit dhe realizimin e Projektit, si dhe të detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) të vendosë në dispozicion të investitorit të dhënat dhe informacionet e rëndësishme për përmbushjen e detyrimeve të investitorit në këtë Marrëveshje dhe/ose të dhëna e informacione që kërkojnë për menaxhimin, operimin dhe zhvillimin e Projektit;

ç) të dorëzojë pasurinë tek investitori dhe të sigurojë që investitori të ushtrojë në mënyrë ekskluzive të drejtat, të cilat i jepen me anë të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë përdorimin e pasurisë, ndërtimin mbi të, si dhe të veprimtarisë që do të zhvillohet në të;

d) të marrë të gjitha masat, duke kërkuar edhe përfshirjen e autoriteteve të tjera shtetërore për të siguruar që pasuria nuk cenohet nga persona të tretë me pretendime për të drejta pronësie mbi pasurinë, si dhe që investitori nuk do të pengohet në realizimin e Projektit, dhe në ushtrimin e veprimtarisë nga persona të tretë me pretendime për të drejta pronësie mbi pasurinë;

dh) të japë, me kërkesë të investitorit, dhe pa asnjë kosto të vonësës së paarsyeshme informacione, dokumente dhe regjistrime që kanë të bëjnë me masterplanin e zonës ku përfshihet pasuria, planet sektoriale të turizmit, të cilat kanë lidhje me Projektin dhe të cilat investitori i kërkon me qëllim për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

e) të marrë masat e nevojshme në bashkëpunim me autoritetet kompetente që të sigurojë ofrimin e infrastrukturës së nevojshme dhe të mjaftueshme që ka të bëjë me burimet e furnizimit nga rrjetet kombëtare me energji, ujësjellës, si dhe të kanalizimeve në rrjetin kryesor, të cilat do të shërbejnë për realizimin e Projektit, si dhe ushtrimin e veprimtarisë;

ë) të vendosë në dispozicion të investitorit, rast pas rasti, të drejtën e përdorimit të zonës së plazhit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për përdorimin e hapësirave të plazhit.

14. TË DREJTAT E INVESTITORIT

14.1 Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, investitori gëzon të drejtat e mëposhtme:

14.1.1 Përdorimin e pasurisë në përputhje me këtë Marrëveshje, gjatë të gjithë afatit të saj;

14.1.2 Gëzimin e qetë të pasurisë, pa ndërhyrje nga palë të treta.

14.1.3 Të drejtat e servitutit sipas Kodit Civil në pasuri shtetërore fqinje, me qëllim realizimin e Projektit dhe përdorimin e pasurisë;

14.1.4 Të drejtën të ndërtojë mbi pasurinë ose të rikonstruktojë strukturat ekzistuese të ndodhura mbi pasurinë nëse ka, në përputhje me Projektin, me projektet dhe skicat, të cilat janë pjesë e dokumentacionit të Projektit dhe me lejet përkatëse të dhëna;

14.1.5 Të përfitojë të ardhurat ekonomike nga përdorimi i pasurisë dhe ushtrimi i veprimtarisë në përputhje me Projektin dhe me këtë Marrëveshje;

14.1.6 Të zgjedhë format më të përshtatshme të administrimit dhe të ofrimit të produkteve turistike;

14.1.7 Investitori ka të drejtë të transferojë pronësinë mbi strukturat e ndërtuara mbi pasurinë, pa cenuar në asnjë rast pronësinë shtetërore mbi pasurinë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Transferimi i strukturave kryhet me kusht që të mos ndryshohet qëllimi, destinacioni i Projektit, si dhe pas marrjes së miratimit paraprak me shkrim të ministrit përgjegjës për turizmin, në përputhje me parashikimet e nenit 36.2.1 të kësaj Marrëveshjeje.

14.1.8 Të drejtën e përdorimit të zonës së plazhit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për përdorimin e hapësirave të plazhit;

14.1.9 Të drejtën e nënkontraktimit të ndërtimit të strukturave të Projektit, si dhe të operimit dhe administrimit të tyre, në përputhje me veprimtarinë turistike që do të zhvillohet aty sipas Projektit të miratuar, me kushtin që objekti i tyre të mos ndryshohet;

14.1.10 Të drejtën për të dhënë me qira ambientet dhe strukturat e realizuara, si dhe shërbimet ose veprimtaritë, të cilat duhet të kryhen në përputhje me Projektin e miratuar dhe me kushtin e ruajtjes së objektit të veprimtarisë.



FAZA E NDËRTIMIT

15. DETYRIMET E INVESTITORIT PËR FAZËN E NDËRTIMIT

15.1 Përveç detyrimeve të tjera të parashikuara në dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, investitori do të ketë detyrimet e mëposhtme:

15.1.1 Investitori detyrohet të përdorë pasurinë vetëm për qëllimin e realizimit të ndërtimeve, rristurimeve, si dhe administrimit dhe ushtrimit të veprimtarisë sipas Projektit të miratuar;

15.1.2 Investitori në asnjë mënyrë nuk do të ndryshojë destinacionin e strukturave të ndërtuara mbi pasurinë sipas Projektit dhe nuk do të ndryshojë objektin e veprimtarisë së kryer në to;

15.1.3 Investitori duhet të realizojë Projektin dhe të ushtrojë veprimtarinë e përcaktuar në të, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe, veçanërisht, në përputhje me legjislacionin për planifikimin e territorit, të mbrojtjes së mjedisit dhe atij për turizmin, si dhe me kërkesat, kriteret dhe rekomandimet e përcaktuara në lejet apo autorizimet e lëshuara për investitorin në bazë të këtij legjislacioni;

15.1.4 Investitori do të realizojë Projektin dhe do të kryejë aktivitetin ndërtimor, në përputhje me skicat, planimetritë, projektin e detajuar (aneksi 2), grafikun e punimeve (aneksi 3), preventivin (aneksi 4), si dhe të gjithë dokumentacionin e lidhur me to (Dokumentacioni teknik) të dorëzuar dhe miratuar pranë autoriteteve kompetente për lëshimin e lejeve dhe autorizimeve për ndërtimin. Për të evituar çdo paqartësi, palët bien dakord se “Dokumentacioni teknik” do t’i bashkëngjitet kësaj Marrëveshjeje pas marrjes së miratimeve përkatëse nga autoritetet kompetente të zhvillimit të territorit;

15.1.5 Investitori detyrohet të sigurojë financimin e realizimit të Projektit në të gjithë fazat e tij, përfshirë ndërtimin, rikonstruksionin, operimin, mirëmbajtjen administrimin dhe ushtrimin e veprimtarisë, siç përcaktohen në Projektin e miratuar;

15.1.6 Investitori do të kryejë realizimin e punimeve duke respektuar të gjitha afatet e përcaktuara në Projekt.

16. DOKUMENTACIONI PËR FAZËN E NDËRTIMIT

16.1 Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe miratimit nga KKTU-ja, investitori duhet të dorëzojë pranë ministrisë versionin përfundimtar të Projektit të detajuar, të

gatshëm për zbatim, në lidhje me fazat e ndërtimit që do të kryhen për realizimin e Projektit, siç është depozituar pranë organeve përkatëse të planifikimit të territorit.

16.2 Për të evituar çdo paqartësi, palët njohin dhe pranojnë se pavarësisht vendimit të KKT-së nr. 10, datë 28.7.2016, si rezultat i ndryshimit të zonës së zhvillimit të Projektit, ndryshim i cili është njohur dhe pranuar nga Komitetit të Investimeve Strategjike me vendimin nr. 22/9, datë 18.7.2022, investitori do të aplikojë sërish për leje ndërtimi për Projektin dhe do të vendosë në dispozicion ministrisë versionin përfundimtar të Projektit, të detajuar në përputhje me nenin 16.1 më sipër.

17. LEJET DHE AUTORIZIMET E NDËRTIMIT

17.1 Investitori duhet të mbajë të informuar rregullisht ministrinë, në lidhje me mbarëvajtjen e procedurave për marrjen e lejeve të ndërtimit dhe do të vërë në dispozicion të saj, nëse kërkohet, të gjithë korrespondencën e mbajtur me autoritetin përkatës për lëshimin e lejeve.

17.2 Në rast se Autoriteti Kompetent për dhënien e lejeve shkakton vonesa në dhënien e tyre dhe nuk i miraton ato brenda afateve ligjore, atëherë investitori duhet të njoftojë ministrinë për vonesën e krijuar dhe shtyrjen e afatit të fillimit të punimeve për sa kohë do të zgjasë vonesa e Autoritetit Kompetent.

18. KRYERJA E PUNIMEVE

18.1 Investitori duhet të fillojë kryerjen e punimeve për realizimin e Projektit, në përputhje me grafikun e punimeve, brenda një afati prej 60 ditësh pune nga dita e marrjes së formularit të lejes së ndërtimit, përveçse kur kërkohet shtyrje e afatit sipas paragrafit 17.2, më lart.

18.2 Punimet duhet të kryhen në përputhje me Projektin dhe dokumentacionin teknik, të miratuar, me dispozitat e legjislacionit për planifikimin e territorit, të legjislacionit për standardet dhe kriteret teknike të ndërtimit, të legjislacionit mjedisor, si dhe në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e lejes së ndërtimit.

18.3 Punimet duhet të kryhen brenda afateve të grafikut të punimeve, si dhe të afateve të përcaktuara në lejen përkatëse të ndërtimit.

18.4 Investitori siguron që nënkontraktori apo çdo palë e përfshirë në kryerjen e punimeve, të:

18.4.1 respektojë legjislacionin shqiptar të punës, si dhe rregullat e sigurisë dhe shëndetit në ambientet



e punës, veçanërisht ato të zbatueshme në kantieret e ndërtimit;

18.4.2 të mos shkaktojë dëme apo dëmtime mbi pasurinë, apo te palë të treta gjatë kryerjes së punimeve;

18.4.3 të sigurojë që çdo shqetësim të pronat fqinje të minimizohet sa më shumë;

18.4.4 që territori në të cilën shtrihet pasuria të jetë i siguruar dhe i mbikëqyrur, në mënyrë që të mos ketë hyrje të personave të paautorizuar;

18.4.5 që territori në të cilën shtrihet pasuria të ruhet nga ana mjedisore, si dhe të trajtojë sipas ligjit të gjitha mbetjet të cilat krijohen si pasojë e punimeve;

18.4.6 që kantieri të ketë furnizimin e nevojshëm me energji, ujë, si dhe shërbime të tjera;

18.4.7 që të gjitha udhëzimet e dhëna nga ministria, nga autoritetet kompetente, si dhe nga dispozitat ligjore, në lidhje me ruajtjen e objekteve me vlerë historike, arkeologjike ose të një natyre tjetër apo të objekteve me interes publik të përcaktuara si të tilla nga ministria, autoritetet kompetente apo dispozitat e legjislacionit në fuqi, të cilat zbulohen ose janë të lokalizuara në territorin e pasurisë, të respektohen me përpikëri.

18.4.8 të respektojë dispozitat e ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, si dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

19. PËRGJEGJËSIA E INVESTITORIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT

Investitori do të jetë plotësisht përgjegjës për çdo mangësi në realizimin e Projektit. Pamundësia e ministrisë për të kundërshtuar ndonjë projekt, skicim projekti ose specifikim apo ndryshim ndaj tij nuk do të interpretohet si heqje dorë nga ministria të ndonjë prej të drejtave të tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose në ndonjë mënyrë ta lehtësojë investitorin nga detyrimet e tij. Në vijim sa më sipër, investitori do të jetë ekskluzivisht përgjegjës për fizibilitetin teknik, kapacitetin operacional dhe besueshmërinë e projektit të zonës dhe çdo komponent të tij.

20. MONITORIMI DHE INSPEKTIMI I FAZËS SË NDËRTIMIT

20.1 Ministria, me urdhër të ministrit, do të ngarkojë një strukturë të caktuar brenda ministrisë apo në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore apo vendore, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit dhe të kësaj Marrëveshjeje nga ana e investitorit gjatë të gjithë afatit të saj (Njësia Monitoruese). Njësia Monitoruese drejton

monitorimin dhe inspektimin e ecurisë së punimeve dhe përputhshmërinë e tyre me Projektin e miratuar, dokumentacionin teknik, si dhe me këtë Marrëveshje. Sipas nevojës, ministria mund të kontrakttojë ekspertë të fushës për monitorim dhe inspektim.

20.2 Investitori do të raportojë çdo 3 muaj te Njësia Monitoruese, në lidhje me mbarëvajtjen e punimeve sipas Projektit dhe dokumentacionit ndërtimor, me një vëmendje të veçantë të respektimi i afateve të grafikut të punimeve, i kostove dhe preventivit, si dhe i standardeve të përcaktuara në Projekt.

20.3 Punonjësit e ministrisë, si pjesë e Njesisë Monitoruese dhe ekspertët e kontraktuar kanë të drejtë të hyjnë në çdo moment në territorin e pasurisë, si dhe në kantierin ku kryhen punimet për realizimin e Projektit. Njësia Monitoruese do të njoftojë investitorin, të paktën 72 orë përpara, në lidhje me ushtrimin e inspektimit në terren. Investitori mund të jetë i pranishëm gjatë inspektimit me anë të personave të caktuar prej tij.

20.4 Nëse gjatë inspektimit, Njësia Monitoruese arrin në përfundimin se punimet nuk janë kryer në përputhje me Projektin e miratuar, dokumentacionin teknik, si dhe me këtë Marrëveshje dhe, në veçanti, në mospërputhje me afatet e grafikut të punimeve, kostot dhe preventivin, si dhe me standardet e përcaktuara në Projekt, atëherë Njësia Monitoruese përpilon, brenda 10 ditësh pune nga dita e inspektimit, një raport, i cili i dërgohet investitorit dhe ku evidentohen të gjitha mospërputhjet e konstatuara nga inspektimi. Investitori ka një afat prej 10 ditësh pune për të dhënë shpjegime me shkrim, në lidhje me mospërputhjet e konstatuara nga Njësia Monitoruese. Pas shpjegimeve të investitorit, Njësia Monitoruese i jep atij një afat të arsyeshëm brenda së cilës investitori duhet të korrigjojë mospërputhjet e konstatuara, si dhe të përmbushë rekomandimet e Njesisë Monitoruese. Në rast se investitori nuk kryen korrigjimet dhe nuk përmbush rekomandimet e Njesisë Monitoruese, ai do të jetë subjekt i penaliteteve, sipas nenit 28 të kësaj Marrëveshjeje.

20.5 Monitorimi dhe mbikëqyrja e Njesisë Monitoruese, për sa i përket fazës së ndërtimit, bëhet me qëllim verifikimin e realizimit të Projektit të miratuar, si dhe përmbushjen e kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk nënkupton gjithësesi përjashtim, zëvendësimin apo reduktimin e



monitorimeve dhe mbikëqyrjeve të autoriteteve të tjera kompetente, të cilat ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me ligje sektoriale, objekt i të cilave investitori do të vazhdojë të jetë.

21. RAPORTET E ECURISË SË NDËRTIMIT

21.1 Që nga fillimi i punimeve dhe gjatë zbatimit të tyre, investitori do t'i paraqesë Njesisë Monitoruese pranë ministrisë raportin 3-mujor të ecurisë, duke dhënë detaje në lidhje me:

- i. zërin e punimeve, si të përfunduara dhe ato në progres;
- ii. punën e parashikuar të përfundojë gjatë 3-mujorit në vazhdim;
- iii. ecurinë drejt afateve të përcaktuara në grafikun e punimeve dhe kohën e llogaritur;
- iv. kostot e ndërtimit dhe përputhshmërinë e tyre me preventivin;

v. çdo ngjarje ose rrethanë që ka të ngjarë të pengojë ose vonojë në mënyrë të arsyeshme arritjen e afateve të përcaktuara.

22. NJOFTIM PARAPRAK PËR VONESA NË REALIZIMIN E PUNIMEVE

22.1 Nëse një pengesë, e cila është jashtë kontrollit të investitorit dhe që shkaktohet për arsytet e parashikuara në nenin 23 më poshtë, mund të çojë në një vonesë në realizimin e punimeve sipas Projektit, investitori duhet të njoftojë ministrinë, brenda një afati prej 15 ditësh pune, në lidhje me llojin e pengesës dhe shkaqet e saj, vonesën që parashikohet të shkaktojë dhe masat që do të ndiqen për të shmangur ose minimizuar vonesën në përfundimin e punimeve të Projektit. Ky parashikim nuk do të cenojë të drejtën mbi shtyrjen e afateve të parashikuara në grafikun e punimeve nga investitori, në përputhje me nenin 23.

23. SHTYRJA E AFATEVE TË PËRCAKTUARA NË GRAFIKUN E PUNIMEVE

23.1 Çdo afat i përcaktuar në grafikun e punimeve, mund të shtyhet në rast se ndodh:

- i. një ngjarje e forcës madhore, siç parashikohet në nenin 37;
- ii. një shkak vonese i autoritetit kompetent siç parashikohet në nenin 17.2;
- iii. një shkak vonese i autoriteteve kompetente për lëshimin e lejeve apo autorizimeve të ndryshme për realizimin e Projektit, e cila nuk ka ardhur si rrjedhojë e mospërmbljes së detyrimeve të investitorit;

iv. zbulimit të relikeve kulturore arkeologjike, fosileve, pirgjeve të dheut për varrime dhe vendeve përkujtimore, mbetjeve artistike historike dhe çdo seksioni tjetër me rëndësi arkeologjike, gjeologjike dhe historike mbi apo nën pasurinë, që kërkon ndërhyrje të autoriteteve kompetente, të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen normale të ndërtimit dhe të përfundimit të punimeve nga investitori, me kusht që shtyrja të jetë në përpjesëtim me kohëzgjatjen e ngjarjes përkatëse, por jo më e gjatë se sa edhe një herë afati i përcaktuar në grafikun e punimeve për atë pjesë të punimeve.

23.2 Në rast se ndodhin ngjarjet e lartpërmendura, ministria do t'i njohë investitorit shtyrjen e afateve të përcaktuara në grafikun e punimeve, por në asnjë mënyrë kompensim financiar.

24. NDËRPRERJA E PUNIMEVE

24.1 Punimet e ndërtimit të Projektit dhe si rezultat, realizimi i tij, do të konsiderohen si të ndërprera nga investitori nëse pa miratimin paraprak të ministrisë për shtyrje, investitori:

- i. njofton ministrinë për vendimin e tij për të ndërprerë të gjithë ose pjesë të punimeve;
- ii. nuk rifillon punimet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh pune pas përfundimit të një ngjarjeje të forcës madhore;

iii. ndërpret të gjitha punimet ose ka vonesa të tilla, kundrejt afateve të punimeve, të konstatuara nga raporti i Njesisë Monitoruese, të cilat përfshijnë 50% të punimeve të parashikuara të Projektit dhe për një periudhë të vazhdueshme prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh pune.

24.2 Data e ndërprerjes së punimeve do të konsiderohet:

- a) në rastin e shqyrtuar në paragrafin “i” më lart, me datën e njoftimit;
- b) në rastet e shqyrtuara në paragrafët “ii” dhe “iii” në datën e raportit të përpiluar në bazë të inspektimit të Njesisë Monitoruese, i cili konstaton:
 - b.i) për rastin “ii” se punimet nuk kanë filluar brenda 90 ditëve pune nga njoftimi për përfundimin e ngjarjes së forcës madhore;
 - b.ii) për rastin “iii” vonesat përfshijnë 50% të punimeve të planifikuara sipas grafikut të punimeve dhe se këto vonesa kanë zgjatur për një periudhë prej 90 ditësh pune.

24.3 Në të dyja rastet 24.2 “ii” dhe “iii” më lart, Njësia Monitoruese jep rekomandime për Investitorin në lidhje me masat që duhen marrë, si



dhe me afatin brenda së cilës duhet të rifillojnë punimet.

25. BRAKTISJA E PROJEKTT

25.1 Projekti do të konsiderohet i braktisur nga investitori, nëse:

- nuk rifillon punimet brenda 90 ditësh pune nga njoftimi i investitorit dërguar ministrisë për ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të punimeve sipas pikës “i”, të nenit 24.1 më lart;

- nuk rifillon punimet brenda 90 ditësh pune nga përfundimi i afatit të dhënë nga Njësia Monitoruese për rifillimin e tyre, në rastet e ndërprerjes sipas pikave “ii” dhe “iii”, të nenit 24.1 më lart;

25.2 Asnjë nga këto afate nuk do të cenojë të drejtën e ministrisë të zbatojë penaltitetet për vonesat, ndërprerjet dhe braktisjen e punimeve apo të drejtave të tjera të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

26. RAPORTI I PËRFUNDIMIT DHE CERTIFIKATA E PËRDORIMIT

26.1 Pas përfundimit të të gjitha punimeve sipas parashikimeve të grafikut të punimeve, investitori do të dërgojë pranë Njesisë Monitoruese, një raport përfundimtar, në lidhje me përfundimin e fazës së ndërtimit të Projektit, ku edhe vë në dijeni Njësine Monitoruese për hyrjen në fazën e kryerjes së kolaudit të ndërtimeve dhe të marrjes së certifikatës së përfundimit.

26.2 Njësia Monitoruese, pas marrjes së raportit nga ana e investitorit, do të kryejë inspektimin e përfundimit të fazës së punimeve të ndërtimit.

26.3 Në rastin kur Njësia Monitoruese arrin në rezultatin se punimet e ndërtimit janë realizuar në përputhje me Projektin e miratuar, atëherë ajo lëshon një raport përfundimtar, në lidhje me këtë dhe njofton investitorin, brenda 5 ditëve pune nga dita e kryerjes së inspektimit. Njësia Monitoruese do të jetë e pranishme edhe gjatë kryerjes së procedurës së kolaudit të ndërtimit.

26.4 Investitori, brenda 3 muajsh nga data e këtij raporti përfundimtar, përfundon të gjitha aplikimet për marrjen e autorizimeve të nevojshme nga autoritetet kompetente, në kuadër të lëshimit të certifikatës së përdorimit.

26.5 Çdo vonesë në lëshimin e autorizimeve përkatëse ose të certifikatës së përdorimit, nga ana e autoriteteve kompetente, e cila lidhet me mosplotësimin korrekt dhe të plotë të dokumentacionit nga ana e investitorit dhe që krijon

vonesa në fillimin e fazës së operimit, do të konsiderohet si vonesë e pajustificuar e investitorit.

26.6 Në rast se Autoriteti Kompetent për dhënien e autorizimit ose të certifikatës së përdorimit shkakton vonesa në dhënien e tyre dhe nuk i miraton ato brenda afateve ligjore, atëherë investitori duhet të njoftojë ministrinë për vonesën e krijuar dhe mund t'i kërkojë edhe shtyrjen e afatit të fillimit të fazës së operimit, për një afat të arsyeshëm. Me marrjen e certifikatës së përdorimit, investitori njofton Njësine Monitoruese, duke i dërguar edhe një kopje të certifikatës së përdorimit.

26.7 Pas marrjes së certifikatës së përdorimit, investitori kryen regjistrimin në zyrën përkatëse të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të strukturave dhe godinave të përfunduara sipas Projektit duke marrë edhe certifikatën e pronësisë së tyre. Investitori i dërgon ministrisë kopje të certifikatave të pronësisë të lëshuara.

27. MOS HEQJA DORË

Inspektimi nga ana e Njesisë Monitoruese dhe pranimi i të gjitha ose pjesëve të punimeve të ndërtimit, materialeve dhe pajisjeve, lëshimi i raportit përfundimtar sipas klauzolës së lartpërmendur apo marrja e certifikatës së përdorimit dhe e autorizimeve në lidhje me të, nuk do të lehtësojnë investitorin nga ndonjë prej detyrimeve ose përgjegjësi të tij, në lidhje me përmbushjen e kësaj marrëveshjeje, realizimit të plotë të Projektit të miratuar, si dhe në lidhje me ndonjë defekt ose vonesë në projektin, ndërtimin, operimin, fillimin dhe/ose përfundimin e pjesëve dhe fazave përkatëse të Projektit.

28. PENALITETET NË LIDHJE ME FAZËN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

28.1 Me përjashtim të rasteve kur investitori ka përmbushur korrigjimet dhe rekomandimet e përcaktuara sipas nenit 20.4 të kësaj Marrëveshjeje ose janë të zbatueshme rastet e shtyrjes së afateve të parashikuara në nenin 23 të kësaj Marrëveshjeje, çdo vonesë në përmbushjen e afateve të përcaktuara në grafikun e punimeve për realizimin dhe përfundimin e fazave të Projektit ngarkon investitorin me detyrimin për të paguar një penaltitet në masën 0.1% të vlerës së garancisë së marrëveshjes për çdo ditë vonesë.

28.2 Penaltiteti llogaritet nga dita e parë e vonesës deri në datën kur konstatohet ndërprerja e punimeve sipas nenit 24 të kësaj Marrëveshjeje, por në asnjë



rast për një periudhë më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë.

28.3 Pagesa e penaliteteve sipas këtij neni nuk përbën heqje dorë nga të drejtat e tjera të ministrisë dhe nuk kufizon të drejtën e saj për të zbatuar masat, pasojat ose mjetet juridike të parashikuara në këtë Marrëveshje, përfshirë ato që lidhen me ndërprerjen ose braktisjen e Projektit sipas neneve 24 dhe 25.

28.4 Zbatimi i penaliteteve sipas këtij neni nuk përjashton të drejtën e ministrisë për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit të provuar, nëse dëmi i pësuar tejkalon vlerën e penaliteteve të aplikuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

FAZA E OPERIMIT

29. DETYRIMET E INVESTITORIT PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË DHE MIRËMBAJTJEN E PASURISË

29.1 Investitori është i detyruar të fillojë operimin dhe ushtrimin e veprimtarisë sipas Projektit të miratuar, brenda një afati prej 90 ditësh pune nga lëshimi i certifikatës së përdorimit nga ana e autoritetit përkatës.

29.2 Përveç detyrimeve të tjera të përcaktuara në këtë Marrëveshje, investitori do të ketë edhe detyrimet e mëposhtme:

29.2.1 Investitori detyrohet të ushtrojë mbi pasurinë vetëm veprimtarinë turistike të përcaktuar në Projektin e miratuar, sipas kushteve, standardeve dhe cilësisë të përshkruar në këtë Projekt;

29.2.2 Investitori nuk duhet të ndryshojë destinacionin e pasurisë dhe të strukturave të ndërtuara mbi pasurinë sipas Projektit të miratuar dhe nuk do të ndryshojë objektin e veprimtarisë të kryer në to;

29.2.3 Investitori duhet të ushtrojë veprimtarinë e përcaktuar në Projektin e miratuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, të zbatueshëm për aktivitetet të cilat do jenë pjesë e veprimtarisë së investitorit, dhe veçanërisht, por pa u kufizuar, në përputhje me legjislacionin në lidhje me ushtrimin e aktivitetit tregtar, të atij për turizmin, mbrojtjen e mjedisit dhe të planifikimit të territorit, si dhe me kërkesat, kriteret dhe rekomandimet e përcaktuara në lejet apo autorizimet e lëshuara për investitorin në bazë të këtij legjislacioni;

29.2.4 Investitori është i detyruar të ofrojë një cilësi të lartë të shërbimeve, në përputhje me standardet e përcaktuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore përkatëse, me ato të kërkuara nga ministria gjatë procedurave konkurruese, me ato të

përcaktuara në Projektin e miratuar, si dhe nga standardet dhe praktikatat e mira ndërkombëtare të zbatueshme për llojin e veprimtarisë së investitorit;

29.2.5 Investitori është i detyruar të sigurojë gjatë të gjithë afatit të kësaj Marrëveshjeje vazhdimësinë e përmbushjes së standardeve dhe kërkesave të përcaktuara më lart, si dhe të kryejë mirëmbajtjen e përgjithshme dhe rikonstruksionin periodik çdo 10 vjet, të strukturave, të cilat janë pjesë e veprimtarisë;

29.2.6 Investitori duhet të promovojë veprimtarinë e ushtruar, me qëllim tërheqjen e një numri sa më të lartë përdoruesish të shërbimeve;

29.2.7 Investitori duhet të garantojë dhe të sigurojë që detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje për investitorin duhet të jenë edhe detyrimet e nënkontraktorëve apo palëve të tjera, të cilave u transferohet operimi i veprimtarisë. Investitori është përgjegjës plotësisht dhe bashkërisht me subjektet e lartpërmendura në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

30. MONITORIMI DHE INSPEKTIMI I VEPRIMTARISË

30.1 Njësia Monitoruese ka të drejtë të hyjë në çdo moment në territorin e pasurisë, duke respektuar destinacionin e saj, si dhe në ambientet ku zhvillohet veprimtaria e investitorit, me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrave të investitorit, në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë sipas kësaj marrëveshjeje, Projektit dhe legjislacionit mbi turizmin. Njësia Monitoruese mund të ushtrojë në çdo moment inspektimin, pa paralajmërim. Investitori mund të jetë i pranishëm gjatë inspektimit me anë të personave të caktuar prej tij.

30.2 Nëse gjatë inspektimit, Njësia Monitoruese konstaton se veprimtaria e ushtruar nuk është në përputhje me detyrimet e investitorit sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas Projektit apo legjislacionit mbi turizmin, atëherë Njësia Monitoruese përpilon, brenda 10 ditësh nga dita e inspektimit, një raport, i cili i dërgohet investitorit dhe ku evidentohen të gjitha mospërputhjet e konstatuara nga inspektimi. Investitori ka një afat prej 10 ditësh për të dhënë shpjegime me shkrim, në lidhje me mospërputhjet e konstatuara nga Njësia Monitoruese. Pas shpjegimeve të investitorit, Njësia Monitoruese i jep atij një afat të arsyeshëm, brenda së cilës investitori duhet të korrigjojë mospërputhjet e konstatuara, si dhe të përmbushë rekomandimet e Njesisë Monitoruese. Në rast se investitori nuk kryen korrigjimet dhe nuk përmbush rekomandimet e



Njesisë Monitoruese ai do të jetë subjekt i penalteteve sipas nenit 35 të kësaj Marrëveshjeje.

30.3 Monitorimi dhe mbikëqyrja e Njesisë Monitoruese për sa i përket fazës së ushtrimit të veprimtarisë bëhet me qëllim verifikimin e realizimit të Projektit të miratuar, si dhe përmbushjen e kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk nënkupton gjithsesi përjashtimin, zëvendësimin apo reduktim të monitorimeve dhe mbikëqyrjeve të autoriteteve të tjera kompetente, të cilat ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me ligjet sektoriale, objekt i të cilave investitori do të vazhdojë të jetë.

31. NJOFTIM PARAPRAK PËR VONESA NË FILLIMIN E VEPRIMTARISË

31.1 Nëse një pengesë e cila është jashtë kontrollit të investitorit, duke përjashtuar arsyet e forcës madhore, mund të çojë në një vonesë në fillimin e ushtrimit të veprimtarisë nga ana e investitorit sipas Projektit, investitori duhet të njoftojë ministrinë brenda një afati prej 10 ditësh pune, në lidhje me llojin e pengesës dhe shkaqet e saj, vonesën që parashikohet të shkaktojë dhe masat që do të ndiqen për të shmangur ose minimizuar vonesën në fillimin e veprimtarisë.

32. SHTYRJA E AFATEVE TË PËRCAKTUARA PËR FILLIMIN E VEPRIMTARISË

32.1 Çdo afat i përcaktuar, në lidhje me fillimin e veprimtarisë sipas Projektit të miratuar, mund të shtyhet në rast se ndodh:

i. një ngjarje e forcës madhore, siç parashikohet në nenin 37;

ii. një shkak vonese e një autoriteti kompetent siç parashikohet në nenin 17.2;

iii. një shkak vonese i autoriteteve kompetente për lëshimin e lejeve apo autorizimeve, i cili nuk ka ardhur si rrjedhojë e mospërmbushjes së detyrimeve të investitorit;

iv. shtyrjet e afateve të fazës së punimeve, sipas nenit 23.

32.2 Në rast se ndodhin ngjarjet e lartpërmendura, ministria do t'i njohë investitorit një shtyrje të afateve të përcaktuara për fillimin e veprimtarisë, por në asnjë mënyrë kompensim financiar.

33. NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË

33.1 Veprimtaria e ushtruar nga investitori sipas Projektit të miratuar, do të konsiderohet si e ndërprerë nga investitori nëse, pa miratimin paraprak të ministrinë për shtyrje, investitori:

i. njofton ministrinë për vendimin e tij për të ndërprerë të gjithë ose pjesë të veprimtarisë;

ii. nuk rifillon veprimtarinë brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh pune pas përfundimit të një ngjarjeje të forcës madhore;

iii. ndërpret të gjitha shërbimet që ofron në kuadër të veprimtarisë së tij ose ka vonesa të tilla kundrejt afateve për fillimin e plotë të ofrimit të këtyre shërbimeve, të konstatuara nga raporti i Njesisë Monitoruese, të cilat përfshijnë 50% të kapacitetit të parashikuar në Projekt dhe për një periudhë të vazhdueshme prej 90 ditësh pune.

33.2 Data e ndërprerjes së veprimtarisë do të konsiderohet:

a) në rastin e shqyrtuar në paragrafin “i” më lart, me datën e njoftimit;

b) në rastet e shqyrtuara në paragrafët “ii” dhe “iii”, në datën e raportit të përpiluar në bazë të inspektimit të Njesisë Monitoruese, i cili konstaton:

b.i) për rastin “ii”, se shërbimet nuk kanë filluar brenda 90 ditëve pune nga njoftimi për përfundimin e ngjarjes së forcës madhore;

b.ii) për rastin “iii”, se vonesat ose mungesa e shërbimeve përfshin 50% të kapacitetit të parashikuar sipas Projektit dhe se këto vonesa ose mungesa kanë zgjatur për një periudhë prej 90 ditësh pune.

33.3 Në të dyja rastet e nenit 33.1 “ii” dhe “iii” më lart, Njësia Monitoruese jep rekomandime për investitorin, në lidhje me masat që duhen marrë, si dhe me afatin brenda së cilës duhet të rifillojë veprimtaria.

34. BRAKTISJA E PROJEKTTIT

34.1 Projekti do të konsiderohet i braktisur nga investitori, nëse:

a) nuk rifillon veprimtarinë brenda 90 ditëve pune nga njoftimi i investitorit dërguar ministrisë për ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të saj sipas pikës “i”, neni 33.1, më lart;

b) nuk rifillon veprimtarinë brenda 90 ditëve pune nga përfundimi i afatit të dhënë nga Njësia Monitoruese për rifillimin e tyre në rastet e ndërprerjes sipas pikave “ii” dhe “iii”, neni 33.1, më lart.

34.2 Asnjë nga këto afate nuk do të cenojë të drejtën e ministrisë të zbatojë penaltetet për vonesat, ndërprerjet dhe braktisjen e veprimtarisë apo të drejta të tjera të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje.



35. PENALITETET NË LIDHJE ME FAZËN E OPERIMIT

35.1 Me përjashtim të rasteve kur investitori ka përmbushur korrigjimet dhe rekomandimet e përcaktuara sipas nenit 30.2 të kësaj Marrëveshjeje ose kur janë të zbatueshme rastet e shtyrjes së afateve të parashikuara në nenin 32 të saj, çdo vonesë në fillimin e veprimtarisë sipas nenit 29.1 të kësaj Marrëveshjeje ngarkon investitorin me detyrimin për të paguar një penaltet në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë për çdo ditë vonesë.

35.2 Penalteti llogaritet nga dita e parë pas përfundimit të afatit të përcaktuar në nenin 29.1 deri në datën kur konstatohet ndërprerja e veprimtarisë sipas nenit 33 të kësaj Marrëveshjeje, por në asnjë rast për një periudhë më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë.

35.3 Pagesa e penalteteve sipas këtij neni nuk përbën heqje dorë nga të drejtat e tjera të ministrisë dhe nuk kufizon të drejtën e saj për të zbatuar masat, pasojat ose mjetet juridike të parashikuara në këtë Marrëveshje, përfshirë ato që lidhen me ndërprerjen ose braktisjen e Projektit sipas neneve 33 dhe 34.

35.4 Zbatimi i penalteteve sipas këtij neni nuk përjashton të drejtën e ministrisë për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit të provuar, nëse dëmi i pësuar tejkalon vlerën e penalteteve të aplikuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

36. TË DREJTAT E PRONËSISË

36.1 Përveçse në rastin kur parashikohet ndryshe në dispozita ligjore, ministria ushtron tagrin ekskluziv të pronarit të pasurisë dhe asgjë në këtë marrëveshje nuk nënkupton kalimin e të drejtës së pronësisë së pasurisë nga ministria tek investitori.

36.2 Investitori do të sillet si pronar i strukturave dhe objekteve të ndërtuara mbi pasurinë në zbatim të Projektit të miratuar dhe për të cilat ai ushtron të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, deri në afatin e përfundimit të saj.

36.2.1 Investitori mund të transferojë tagrin sipas pikës së mësipërme tek të tretët për ato struktura të ndërtuara mbi pasurinë vetëm pas marrjes së miratimit paraprak me shkrim të ministrit përgjegjës për turizmin. Miratimet e dhëna nga ministri sipas kësaj pike bëhen pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje si aneks i veçantë. Miratimi mund të përfshijë një ose më shumë struktura apo njësi të përcaktuara në Projektin e miratuar, të identifikuar qartë në aktin përkatës të miratimit.

Ky kufizim nuk cenon të drejtën e investitorit për të transferuar tek të tretët të drejtën e përdorimit, administrimit, dhënies me qira apo shfrytëzimit të strukturave të ndërtuara mbi pasurinë, për sa kohë që nuk transferohet pronësia mbi to.

Në kuadër të zbatimit dhe financimit të Projektit, marrëveshjet e investitorit me shoqëritë zbatuese të ndërtimit, furnitorët, konsulentët dhe financuesit e Projektit, si dhe krijimi i barrëve siguruese ose garancive në favor të financuesve, nuk konsiderohen transferime që kërkojnë miratim sipas kësaj pike, për sa kohë që nuk sjellin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, transferimin e pronësisë mbi strukturat e zhvilluara mbi pasurinë objekt të kësaj Marrëveshjeje.

Krijimi i barrëve siguruese ose garancive në favor të financuesve mund të bëhet vetëm mbi pasuritë private të investitorit, mbi të drejtat e tij kontraktore ose mbi strukturat që janë në pronësinë e investitorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në asnjë rast nuk mund të krijohen barrë siguruese, hipoteka apo garanci reale mbi pasurinë shtetërore objekt të kësaj Marrëveshjeje, e cila mbetet pronë e shtetit dhe nuk mund të jetë objekt ekzekutimi, tjetërsimi apo rëndimi me barrë siguruese nga investitori.

Miratimi paraprak me shkrim i ministrit përgjegjës për turizmin jepet vetëm nëse transferimi nuk cenon qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, nuk ndryshon destinacionin e Projektit të miratuar, nuk shmang detyrimet e investitorit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe nuk dëmton interesin publik apo interesin pasuror të shtetit.

Kufizimet e parashikuara në këtë pikë zbatohen vetëm për pjesën e Projektit të zhvilluar mbi pasurinë objekt të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk shtrihen mbi pasuritë private të investitorit, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje ose në legjislacionin në fuqi.

37. FORCA MADHORE

37.1 Rastet e forcës madhore

37.1.1 “Rast i forcës madhore” do të thotë çdo ngjarje ose rrethanë, ose kombinim i ngjarjeve ose rrethanave që tërësisht ose pjesërisht parandalojnë çdo palë nga përmbushja e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje, por vetëm nëse dhe në masën që raste dhe rrethana të tilla:

i. nuk janë brenda kontrollit të arsyeshëm, të drejtpërdrejtë ose jo, të palës së ndikuar;

ii. nuk janë rezultat i shkeljes ose pamundësisë së pagesës nga pala e ndikuar;



iii. nuk do të mund të evitoheshin nëse pala e ndikuar do të kishte marrë masa të arsyeshme.

37.1.2 Rasti i forcës madhore përfshin, por nuk kufizohet në, ngjarjet dhe rrethanat e mëposhtme në masën që ato ose pasojat e tyre plotësojnë kërkesat e mësipërme, si dhe paragrafin 37.3 (Detyrimi për të deklaruar forcën madhore) dhe paragrafin 37.4 (Detyrimi për ndreqjen e forcës madhore):

i. çdo veprim lufte (qoftë kjo e deklaruar apo jo) luftë civile, pushtim, konflikt i armatosur ose veprim i një armiku të jashtëm, protestë ose terrorizëm, në secilin rast përfshin ose drejtpërsëdrejti ndikon në pasurinë dhe veprimtarinë e zhvilluar;

ii. revolucion, protestë, rebelim ose çdo kryengritje civile, akt terrorizmi ose sabotimi, që në secilin rast përfshin ose drejtpërsëdrejti ndikon në pasurinë dhe veprimtarinë e zhvilluar;

iii. grevat që kanë përhapje të gjerë dhe ose janë kombëtare dhe ose politike;

iv. çdo tërmet, vërshim ujërash, zjarr, uragane ose çdo fenomen natyror ose fatkeqësi mjedisore që ndikon drejtpërsëdrejti ose jo drejtpërsëdrejti në pasuri dhe në veprimtarinë e zhvilluar;

v. kontaminimi nuklear, kimik ose biologjik që drejtpërsëdrejti ose jo drejtpërsëdrejti ndikon në pasurinë dhe në veprimtarinë e zhvilluar, përveçse kur burimi ose shkak i një kontaminimi të tillë është rezultat i veprimeve të investitorit ose të ndonjë prej kontraktorëve të investitorit;

vi. epidemi ose infeksione që drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të tërthortë ndikojnë në pasurinë dhe veprimtarinë e zhvilluar.

37.2 Mospërbushja e justifikuar e detyrimeve

Asnjë palë nuk do të konsiderohet se nuk ka përmbushur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje kur, dhe në masën që, përmbushja e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje pengohet ose tërësisht, ose pjesërisht, nga çdo rrethanë e forcës madhore që lind pas datës së kësaj Marrëveshjeje dhe çdo palë do të jetë e autorizuar të pezullojë përmbushjen e detyrimeve në masën që kjo palë është e penguar tërësisht ose pjesërisht nga përmbushja e detyrimeve të veta, sipas kësaj marrëveshjeje nga kjo rrethanë e forcës madhore. Në rast të ngjarjes së një force madhore, investitori nuk do të jetë subjekt i penaliteteve.

37.3 Detyrimi për të deklaruar forcë madhore

Nëse ndonjë palë do të mbështetet në ngjarjen e një force madhore si bazë për justifikimin e mospërmbushjes së detyrimit sipas kësaj

Marrëveshjeje, atëherë pala që mbështetet në ngjarjen ose kushtet do të njoftojë menjëherë palën tjetër për ngjarjen ose kushtet, duke dhënë një vlerësim të kohëzgjatjes së pritur dhe ndikimin e mundshëm në përmbushjen e detyrimeve këtej e tutje.

37.4 Detyrimi për ndreqjen e forcës madhore

Në varësi të paragrafit 37.3, më lart, nëse njëra prej palëve do të mbështetet në ngjarjen e një force madhore, si bazë për t'u justifikuar për mospërmbushjen e detyrimeve sipas kësaj kontrate, atëherë pala që mbështetet te ngjarja ose te kushtet, do të:

a) ushtrojë çdo përpjekje të arsyeshme për të vazhduar të kryejë detyrimet e saj;

b) do të ndërmarrë menjëherë veprime për të korrigjuar apo riparuar ngjarjen ose kushtet që justifikojnë përmbushjen e detyrave;

c) të ushtrojë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të lehtësuar ose kufizuar dëmet e palës tjetër në atë masë që një veprim i tillë nuk do të ndikonte në dëm të interesit të tij; dhe

ç) do të njoftojë periodikisht palën tjetër, në lidhje me veprimet e saj dhe planet për veprime në përputhje me "a", "b" dhe "c" më lart dhe do të njoftojë menjëherë palën tjetër për ndërprerjen e ngjarjes ose të kushteve që e shkaktuan forcën madhore.

37.5 Zgjatja e afatit për shkak të forcës madhore

Në varësi të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mbi zgjidhjen për shkak të forcës madhore të tejzgjatur, nëse një rast i forcës madhore me kohëzgjatje më shumë se 6 muaj ndodh ose rastet e forcës madhore të marra së bashku kanë një kohëzgjatje të përgjithshme mbi 12 muaj, atëherë afati i përdorimit të pasurisë mund të zgjatet vetëm për periudhën gjatë së cilës ngjarja e forcës madhore ka penguar efektivisht përmbushjen e detyrimeve që lidhen me realizimin ose ushtrimin e Projektit. Kjo zgjatje nuk zbatohet automatikisht dhe përcaktohet në përputhje me ndikimin efektiv të ngjarjes së forcës madhore dhe me dispozitat e nenit 39.1. Zgjatja e afatit të përdorimit nuk cenon të drejtën e secilës palë për zgjidhjen e Marrëveshjes në rast të forcës madhore të tejzgjatur, sipas nenit 39.1.

38. DEKLARIMET DHE GARANCITË

38.1 Ministria

38.1.1 Ministria deklaron, garanton dhe merr përsipër ndaj investitorit se, që nga data e



nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe deri në datën e hyrjes në fuqi:

a) ka kompetenca dhe autoritet të plotë të lidhë këtë Marrëveshje;

b) si rrjedhojë e krijimit, dhënies dhe regjistrimit të së drejtës së përdorimit të pasurisë dhe të dorëzimit të saj tek investitori, investitori do të gëzojë të drejta të plota për përdorimin dhe posedimin e pasurisë, si dhe të ushtrimit të veprimtarisë të lidhur me të;

c) përgjatë afatit, pasuria në pronësi të ministrisë:

- nuk është apo ka qenë subjekt konfliktesh të njohura pronësie; ii. është dhe do të mbetet e lirë nga çdo barrë siguruese apo të drejta të palëve të treta, duke përfshirë pa kufizim, edhe çdo pretendim për çfarëdolloj të drejte të palëve të treta; iii. nëse pasuria bëhet objekt i ndonjë konflikti pronësie, ministria do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për ta zgjidhur atë brenda një afati sa më të shkurtër dhe për të mbajtur të pacenuar investitorin nga konflikte dhe procedura të tilla;

ç) ka kryer të gjitha veprimet e duhura për lidhjen e kësaj marrëveshjeje dhe përmbushjen e detyrimeve të saj, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi; dhe

38.2 Investitori

38.2.1 Investitori deklaron, garanton dhe merr përsipër ndaj ministrisë se, që nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, dhe në çdo kohë më pas gjatë afatit të saj:

a) ka kompetencat dhe autoritet të plotë për të lidhur këtë Marrëveshje, ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme për të marrë autorizimin për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, si dhe përmbushjen e detyrimeve sipas saj;

b) gëzon kapacitetin dhe gjendjen financiare të mjaftueshme për të ndërmarrë këtë Projekt, duke përfshirë ndërtimin dhe ushtrimin e veprimtarisë, si dhe nuk do të ndërmarrë detyrime financiare me palë të treta, të cilat do të përkeqësojnë gjendjen e tij financiare aq sa të përbënin një rrezik për realizimin me sukses të Projektit, si dhe të ushtrimit të veprimtarisë;

c) nënshkrimi, regjistrimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit, nuk do të jetë në kundërshtim, rezultojë në ndonjë shkelje, nuk do të përbejë një mospërmbushje apo nuk do të përshpejtojë zbatimin e kërkuar të ndonjë prej dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, ndonjë angazhimi, kontrate, traktati, memorandumit mirëkuptimi, dekreti apo urdhri në të cilën ajo është

palë ose me të cilën ajo vetë, apo pronat e saj janë të lidhura apo të prekur;

ç) nuk ka veprime, padi, procedime ose hetime në zhvillim, në dijeni të investitorit, të drejtuar kundër tij përpara çdo trupi gjyqësor ose përpara çdo autoriteti gjyqësor, ose autoriteti tjetër, përfundimi i të cilave mund të rezultojë në shkelje ose të përbëjë një mospërmbushje nga investitori sipas kësaj marrëveshjeje;

d) nuk do të vendosë asnjë barrë siguruese mbi strukturat dhe ndërtimet mbi pasuri përveç sa parashikohet në Marrëveshjet dhe dokumentacionet në lidhje me to, të ndërmarrë për financimin e Projektit, ose me miratimin paraprak të ministrisë;

dh) investitori është i organizuar dhe operon në përputhje me rregullat dhe parimet e qeverisjes së mirë të shoqërisë.

38.3 Deklarimet dhe garancitë sipas këtij neni konsiderohen si të përsëritura nga investitori në çdo ditë gjatë afatit.

39. ZGJIDHJA E PARAKOHSHME E MARRËVESHJES

39.1 Zgjidhja për shkak të forcës madhore të tejzgjatur

Nëse një rast i forcës madhore vazhdon ose është e mundur të vazhdojë për një periudhë më të gjatë se 6 muaj të njëpasnjëshëm, sipas gjykimit të arsyeshëm të palëve, përveç të drejtës së parashikuar në paragrafin 37.5, më lart, çdo palë mund të zgjidhë këtë marrëveshje duke i dërguar me shkrim palës tjetër, një njoftim për zgjidhje, jo më vonë se 1 muaj nga data e njoftuar për zgjidhje.

39.2 Zgjidhja e Marrëveshjes nga investitori

39.2.1 Investitori ka të drejtë të zgjidhë këtë Marrëveshje para mbarimit të afatit në rastet kur ministria është në një rast të mospërmbushjes së detyrimit, sipas kësaj Marrëveshjeje. Investitori i dërgon ministrisë një njoftim ku konstaton rastin e mospërmbushjes së detyrimit dhe i kërkon asaj përmbushjen e detyrimit, duke i lënë një afat të arsyeshëm dhe të përshtatshëm për llojin e detyrimit që duhet të përmbushet por që gjithsesi jo më të shkurtër se 2 muaj dhe jo më të gjatë se 4 muaj. Në rast se ministria nuk e përmbushë detyrimin brenda afatit të arsyeshëm të vendosur në dispozicion nga investitori atëherë investitori ka të drejtë të zgjidhë këtë Marrëveshje, duke i dërguar ministrisë një njoftim me shkrim për zgjidhje të Marrëveshjes (njoftim për zgjidhje) jo më vonë se 2 muaj nga data e njoftuar për zgjidhje.



39.2.2 Ministria ndodhet në një rast të mospërbushjes së detyrimit, kur:

- i. në rast të mospërbushjes së kushteve përkatëse paraprake nga ana e ministrisë;
- ii. nuk kryen dorëzimin e pasurisë sipas nenit 8 të Marrëveshjes;
- iii. nuk përmbush një nga detyrimet e ministrisë sipas nenit 13;
- iv. në rast të mospërbushjes së deklaratave dhe garancive sipas nenit 38.1;

39.3 Zgjidhja e Marrëveshjes nga ministria

39.3.1 Ministria ka të drejtë të zgjidhë këtë Marrëveshje para mbarimit të afatit në rastet kur investitori është në një rast të mospërbushjes së detyrimit, sipas kësaj Marrëveshjeje. Për mospërbushjet që, për nga natyra e tyre, janë të korigjueshme, ministria i dërgon investitorit një njoftim paraprak ku konstaton rastin e mospërbushjes dhe i kërkon atij përmbushjen e detyrimit, duke i lënë një afat të arsyeshëm dhe të përshtatshëm për llojin e detyrimit që duhet të përmbushet, por që gjithsesi nuk mund të jetë më i shkurtër se 2 muaj dhe më i gjatë se 4 muaj, përveç rasteve kur kjo Marrëveshje parashikon një afat ose procedurë të posaçme korigjimi, të cilat do të zbatohen sipas parashikimeve përkatëse. Në rast se investitori nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të zbatueshëm, ministria ka të drejtë të zgjidhë këtë Marrëveshje duke i dërguar investitorit njoftimin për zgjidhje të Marrëveshjes, jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data e njoftimit paraprak për zgjidhje.

39.3.2 Investitori ndodhet në një rast të mospërbushjes së detyrimit, kur:

- i. nuk përmbush një nga kushtet paraprake të përcaktuara në nenin 6, brenda një afati prej 9 muajsh;
- ii. nuk përmbush një nga detyrimet e investitorit të përcaktuara në këtë marrëveshje, në bazë të rekomandimeve dhe afateve të dhëna nga Njësia Monitoruese, veçanërisht por pa u kufizuar në to, detyrimet e neneve 15, 16, 17, 18, 21, 25, 29, 34;
- iii. pengesa dhe mos lejimi nga ana e investitorit të personave të autorizuar apo të pjesëtarëve të Njesisë Monitoruese për të ushtruar aktivitetin e tyre inspektues sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç kur kjo pengesë justifikohet me natyrën dhe rregullat e aktivitetit të ushtruar në pasuri nga investitori;
- iv. shpallja e paaftësisë paguese nga ana e investitorit apo hapja e procedurave të falimentimit nga gjykata kompetente në Shqipëri;

v. marrja e një vendimi apo e një mase nga autoritetet administrative apo gjyqësore, të cilat do të bënin të pamundur vazhdimësinë e ushtrimit të aktivitetit nga ana e investitorit.

vi. shkelja materiale e detyrimeve thelbësore të investitorit sipas kësaj Marrëveshjeje, kur shkelja, për nga natyra e saj, cenon në mënyrë të rëndë realizimin, operimin ose qëllimin e Projektit.

40. SIGURIMI I MARRËVESHJES

40.1 Investitori paraqet sigurimin e Marrëveshjes brenda afatit të përcaktuar në nenin 6.1.1, si kusht paraprak për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe, në çdo rast, përpara hyrjes në fuqi të saj, në përputhje me nenin 8, pika 4, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Sigurimi i Marrëveshjes vendoset në masën 10% (dhjetë përqind) të vlerës së investimit që do të zhvillohet mbi pasurinë objekt të kësaj Marrëveshjeje dhe dokumentacioni përkatës i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje, si aneksi 5.

40.2 Sigurimi i Marrëveshjes do të sigurojë përmbushjen e duhur dhe në kohë të detyrimeve të investitorit që nga data e hyrjes në fuqi deri në lëshimin e certifikatës së përdorimit nga autoriteti kompetent. Kohëzgjatja e sigurimit të Marrëveshjes do të vazhdojë edhe për një periudhë 12-mujore pas lëshimit të certifikatës së përdorimit.

40.3 Ministria do të kthejë sigurimin e marrëveshjes pasi të ketë përfunduar afati i përcaktuar në paragrafin 40.2 dhe në përputhje me dispozitat e nenit 41, më poshtë.

41. EKZEKUTIMI MBI SIGURIMIN E MARRËVESHJES

41.1 Në rast të zbatimit të penaliteteve gjatë fazës së punimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje, ministria ka të drejtë të ekzekutojë penaltetet mbi vlerën e garancisë së marrëveshjes.

41.2 Në rastin e zgjidhjes së parakohshme të Marrëveshjes nga ana e ministrisë, si rezultat i mospërbushjeve dhe shkeljeve të kësaj marrëveshjeje nga investitori, në lidhje me detyrimet e tij gjatë fazës së punimeve, atëherë ministria mban të gjithë vlerën e garancisë, pa cenuar të drejtën e tij për të kërkuar dëmshpërblimet e tjera.

42. SIGURIMET

42.1 Investitori do të mbulojë me siguracion të përshtatshëm të gjithë strukturat dhe ndërtimet sipas Projektit, si gjatë fazës së ndërtimit, ashtu dhe gjatë fazës së ushtrimit të aktivitetit dhe paraqet ose merr



masa për paraqitjen e kopjeve të certifikuara të çdo certifikate sigurimesh tek ministria.

43. E DREJTA E NDËRHYRJES SË PALËS FINANCUESE DHE E ZËVENDESIMIT

43.1 Në rastin kur ministria zgjedh të ushtrojë të drejtën për zgjidhjen e Marrëveshjes, ajo dërgon tek investitori njoftimin për zgjidhje, sipas nenit 39.3, si dhe palës financuese një njoftim për vendimin e saj.

43.2 Të drejtat që mund të burojnë për palën financuese nga marrëveshja përkatëse e financimit, pas njoftimit për zgjidhjen e Marrëveshjes ose pas marrjes së një vendimi të formës së prerë për zgjidhjen e saj, ushtrohen vetëm brenda kufijve të të drejtave që i njihen investitorit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe legjislacionit në fuqi. Këto të drejta nuk mund të shtrihen mbi pasurinë shtetërore, nuk krijojnë detyrime për ministrinë, e cila nuk është palë në marrëveshjen e financimit, nuk kufizojnë ushtrimin e të drejtave të ministrisë sipas kësaj Marrëveshjeje dhe nuk cenojnë regjimin juridik ose pronësinë shtetërore mbi pasurinë. Çdo zëvendësim i investitorit ose ushtrim i të drejtave që sjell një ndryshim të tillë mund të kryhet vetëm në përputhje me procedurat dhe miratimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe kjo Marrëveshje.

44. E DREJTA E NDËRHYRJES SË MINISTRISË DHE E ZËVENDESIMIT

44.1 Nëse ministrisë i lind e drejta e zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje, ministria ka të drejtë që pas datës së njoftuar për zgjidhjen e Marrëveshjes ose pas vendimit formës së prerë të autoritetit kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, i cili e zgjidh këtë Marrëveshje, të zëvendësojë investitorin me një subjekt tjetër, i cili do të përzgjidhet nga ministria sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

44.2 Secila nga palët në këtë Marrëveshje pranon të nënshkruajë apo sigurojë pranimin e kushteve të këtij neni në marrëveshje të tjera me palë të treta.

45. DORËZIMI PAS PËRFUNDIMIT TË AFATIT

45.1 Në 6 (gjashtë) muajt e fundit të afatit, investitori, në momentin që normalisht është e mundur, do të fillojë përmbushjen e detyrimeve të dorëzimit dhe do të bashkëpunojë e do t'i sigurojë ministrisë ose çdo pale të tretë të caktuar prej saj të gjithë aksesin dhe informacionin e nevojshëm për marrjen në dorëzim të operimit të zonës. Gjatë kësaj periudhe, palët do të përgatisin inventarin e pasurive,

strukturave, pajisjeve, dokumenteve dhe të drejtave që do t'i transferohen ministrisë sipas këtij neni.

45.2 Menjëherë në fund të afatit, përpara nënshkrimit të aktit të përfundimit të Marrëveshjes dhe marrjes në dorëzim, palët do të kryejnë inventarizimin dhe verifikimin e përbashkët të gjendjes së pasurisë, strukturave, godinave, pajisjeve dhe punimeve dhe do të hartojnë e nënshkruajnë një procesverbal të dorëzimit, ku përcaktohen qartë pasuritë, të drejtat dhe dokumentacioni që transferohen, gjendja e tyre, çdo mangësi e konstatuar dhe masat përkatëse. Transferimi dhe dorëzimi kryhen sipas këtij procesverbali dhe aktit të përfundimit të Marrëveshjes:

i. Pasuria, strukturat dhe godinat, si dhe i gjithë ambienti duhet të jetë në një gjendje të arsyeshme riparimi, pastërtie dhe paraqitjeje, duke marrë parasysh afatin e përdorimit dhe zhvlerësimin e arsyeshëm dhe në gjendje për të përmbushur standardet e përcaktuara në këtë marrëveshje. Çdo mangësi e konstatuar në këtë aspekt përbën një të drejtë të ministrisë për të kërkuar dëmshpërblim;

ii. Të drejtat e investitorit sipas kësaj Marrëveshjeje do të përfundojnë automatikisht dhe investitori nuk do të ketë më të drejtë për ta përdorur dhe gëzuar pasurinë, dhe çdo pasuri të paluajtshme mbi të;

iii. Investitori do t'i transferojë menjëherë ministrisë, të çliruara nga të gjitha barrët dhe të çdo të drejte tjetër të regjistruar mbi to, të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat e investitorit në dhe për pasurinë, si më poshtë:

- të gjitha materialet dhe pajisjet, dhe pjesët e ndërrimit;

- të gjithë pasurinë personale jofizike që përfshin të drejtat e pronësisë intelektuale (që nuk janë transferuar tashmë nga licenca);

- të gjitha ndërtimet dhe instalimet;

- regjistrimet, raportet, të dhënat, dosjet dhe informacioni, skicimet, dokumentet e kompjuterizuara dhe jo të kompjuterizuara;

- të gjitha garancitë e pajisjeve, materialeve dhe punimeve;

- të gjitha të drejtat e kontratave të qirasë, nënqirasë dhe mirëmbajtjes, sipas rastit, dhe policat e sigurisë;

- të gjitha punimet në progres (duke përfshirë punimet e ndërtimit ose mirëmbajtjes, nëse është e zbatueshme) sipas kontratave me shitës, furnizues, kontraktorë dhe nënkontraktorë;



iv. Investitori ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për të realizuar çdo transferim të parashikuar në këtë nen (duke përfshirë përpilimin e çdo dokumentacioni të kërkuar dhe marrjen përsipër të çdo detyrimi ose marrëveshjeje) me ministrinë (ose çdo palë të tretë të caktuar) dhe duke mos i shkaktuar kosto ose shpenzim ministrisë; dhe

v. Ministria është përgjegjëse për marrjen ose realizimin me shpenzimet e veta të të gjitha autorizimeve për të operuar Projektin dhe pasurinë (ose transferuar operimin e tij tek një palë e tretë), dhe investitori do të asistojë ministrinë në identifikimin dhe përfundimin e çdo autorizimi të tillë, duke përfshirë dhënien e asistencës së arsyeshme për përgatitjen e kërkesave përkatëse.

45.3 Në rastin e mosrespektimit material nga investitori të kërkesave të këtij neni, ministria ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimet dhe kompensimet përkatëse.

45.4 Palët do të nënshkruajnë aktin e përfundimit të Marrëveshjes (aneksi 6), sipas afatit, si dhe të marrjes në dorëzim të pasurive dhe të drejtave të përmendura më lart.

46. EFEKTE TË PËRFUNDIMIT TË MARRËVESHJES ME INVESTITORIN

46.1 Në çdo rast të përfundimit të Marrëveshjes sipas dispozitave të saj, investitorit i humb çdo e drejtë e fituar mbi pasurinë, si dhe çdo e drejtë mbi pjesët e punimeve dhe/ose ndërtesat dhe/ose strukturat e ndërtuara mbi pasurinë. Dorëzimi, inventarizimi, verifikimi i gjendjes dhe transferimi i pasurive, të drejtave dhe dokumentacionit kryhen sipas procedurës së përcaktuar në nenin 45, për aq sa ajo është e zbatueshme.

46.2 Pronësia e çdo punimi dhe/ose ndërtese dhe/ose strukture mbi pasurinë i kalon ministrisë në përfundim të procedurës së dorëzimit dhe transferimit të përcaktuar në nenin 45, ndërsa në rast të zgjidhjes së parakohshme, në përputhje me procedurën e parashikuar në këtë Marrëveshje dhe legjislacionin në fuqi. Investitori pranon se, pas përfundimit të kësaj procedure, humb çdo të drejtë dhe çdo pretendim mbi to.

46.3 Ministria bën kërkesën pranë zyrës kompetente të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për çregjistrimin e së drejtës së përdorimit të pasurisë nga investitori, si dhe regjistrimin e çdo punimi dhe/ose ndërtese dhe/ose strukture mbi pasurinë në pronësi të ministrisë.

47. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

47.1 Çdo mosmarrëveshje mes palëve kontraktuese, që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e Marrëveshjes, duke përfshirë, por jo vetëm, çështjet që kanë të bëjnë me përfundimin e saj, mospërmbushjet, zgjidhjen, pavlefshmërinë, qofshin këto të përfshirë në marrëveshje apo në anekset e saj, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, duke u bazuar në vullnetin e mirë. Palët mund të bien dakord që mosmarrëveshjet të zgjidhen edhe nëpërmjet procedurave të ndërmjetësimit, sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

47.2 Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet me mirëkuptim ose ndërmjetësim, si më lart, palët do t'i drejtohen gjykatës kompetente sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

48. DISPOZITA TË FUNDIT

48.1 Konfidencialiteti. Secila nga palët do të trajtojë si konfidenciale të gjithë dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me Projektin, qofshin këto në formë të shkruar apo gojore, qofshin teknike apo tregtare, që u janë dhënë atyre nga çdo palë ose në emër të cilësdo palë tjetër në këtë Marrëveshje dhe nuk duhet t'ia bëjë të ditur një palë të tretë dhe as t'ia komunikojë pa pranimin e shkruar të palës tjetër, përveçse kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi, nga autoritete rregullatore, hetimore apo gjyqësore, si dhe përveçse kur jepet për qëllimet e përmbushjes së kushteve të marrëveshjeve të financimit me palën financuese.

48.2 Gjuha. Kjo marrëveshje do të hartohet dhe zbatohet në gjuhën shqipe. Të gjitha komunikimet dhe njoftimet ndërmjet palëve, në lidhje me të do të jenë në gjuhën shqipe.

48.3 Njoftimet. Çdo njoftim ose komunikim tjetër nga një palë për palën tjetër, që kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje:

i. do të bëhet në gjuhën shqipe;

ii. do të bëhet me shkrim;

iii. do të dorëzohet personalisht (dorazi) ose do të dërgohet me postë rekomande të parapaguar ose me korrier në adresën e palës tjetër që jepet më poshtë; dhe

iv. shënohet në vëmendje të personit/ave të caktuar më poshtë ose të ndonjë personi/ash të tjerë siç pala tjetër do ta kërkojë me njoftim.

Për qëllime të komunikimit, lidhur me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, palët caktojnë pikat e mëposhtme të kontaktit:



Për Investitorin [Zoti Skënder Madani, Administrator]

Për Ministrinë [Zoti XXXXXX]

Personat e kontaktit do të mund të ndryshohen nga palët, duke i dërguar një njoftim me shkrim palës tjetër.

48.4 Ligji i zbatueshëm. Kjo marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

48.5 Ndryshimi i Marrëveshjes. Kjo Marrëveshje do të ndryshohet vetëm me anë të marrëveshjes me shkrim midis palëve.

48.6 Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje është e vlefshme duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të saj, pas plotësimit të kushteve paraprake të përcaktuara në nenin 6, deri në përfundim të afatit të saj.

Nëse një kusht ose dispozitë e kësaj Marrëveshjeje konsiderohet i pavlefshëm ose i paligjshëm ose i pazbatueshëm, dispozitat e mbetura të Marrëveshjes nuk do të cenohen, ndërsa palët angazhohen të zëvendësojnë dispozitën e pavlefshme me një të vlefshme brenda një afati të arsyeshëm.

Kjo Marrëveshje është hartuar në 3(tre) kopje origjinale, të gjitha me vlerë të njëjtë.

Për Ministrinë

Për Investitorin

VENDIM

Nr. 1327, datë 11.9.2026

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR ZBATIMIN E NENEVE 4 DHE 9, TË LIGJIT NR. 9121/2003, NË SEKTORIN E TRANSPORTIT DETAR, PËRFSHIRË KABOTAZHIN DHE SHËRBIMET NDËRKOMBËTARE TË LUNDRIMIT TË LIRË (TRAMP SERVICES)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen, e:

Z. Denar Biba kryetar;

Znj. Leida Matja zëvendëskryetar;

Znj. Rezana Konomi anëtar;

Z. Durim Kraja anëtar;

Znj. Fatjola Delija anëtar,

në mbledhjen e tij të datës 11.9.2026, shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Mbi miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, në sektorin e transportit detar, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (*tramp services*)”

BAZA LIGJORE: Neni 24, shkronja “d” dhe neni 26, i ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

- Draftregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, në sektorin e transportit detar, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (*Tramp services*)”,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, në sektorin e transportit detar, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (*Tramp services*)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Kryetar: Denar Biba

Zëvendëskryetar: Leida Matja

Anëtarë: Rezana Konomi, Durim Kraja, Fatjola Delija

**RREGULLORE**

“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
DETAJUARA PËR ZBATIMIN E NENEVE 4
DHE 9, TË LIGJIT NR. 9121/2003, NË
SEKTORIN E TRANSPORTIT DETAR,
PËRFSHIRË KABOTAZHIN DHE
SHËRBIMET NDËRKOMBËTARE TË
LUNDRIMIT TË LIRË (TRAMP
SERVICES)”²

Neni 1

Dispozitat që lidhen me marrëveshjet, vendimet dhe praktikat e bashkërenduara në sektorin e transportit detar zbatohen për të gjitha format e shërbimeve detare, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të anijeve të lundrimit të lirë, në përputhje me nenet 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Neni 2

Autoriteti i Konkurrencës ushtron kompetencat e tij për hetimin e shkeljeve të konkurrencës dhe vendosjen e masave përkatëse administrative, në përputhje me ligjin nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin e saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

² Ky akt është përafuar me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1419/2006, datë 25 shtator 2006, që shfuqizon Rregulloren (EEC) nr. 4056/86, e cila përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e neneve 85 dhe 86, të Traktatit në

transportin detar, dhe ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1/2003, lidhur me zgjerimin e fushës së zbatimit të saj për të përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (*Tramp services*).



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË][Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare][Viti: 2026 - Numri: 200][Datë: 16.09.2026 13:58:13 +02:00][36c8f135-f19d-4bdb-afc0-b93966ca4971]

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e Botimeve Zyrtare)